KOSOVA

DJEPI I SHQIPTARIZMIT

KLISHE N. A. KOSTURI - TIRANË

949.651(093

BIBLIOTEKA SHQIPTARE

HAMIT KOKALARI

KOSOVA

DJEPI I SHQIPTARIZMIT

BIBLIOTEKA
DHURATE
KOMBET

TIRANE
MESAGJERIT SHQIPTARE
1943

ÇDO E DREITË I RËZERVOHET AUTORIT

Nr.inv.

SHTYPSHKRONJA E SHTETIT - TIRANË

PASQYRA E LËNDËS

Parathënëjë . . . . . faqe 7
Konsiderata historike . . . . . » 11
Konsiderata etnike . . . . . » 29
A) Hartat etnografike . . . . . » 31
B) Dokumenta etnografike të ndryshme . . . . » 32
C) Shifrat statistike . . . . . » 33
D) Proporcioni i populisis shqiptare . . . . » 38
Vepra e çkombëtarëzimit e kryer kundër elementit shqiptar të Kosovës . . . . . » 49
Kolonizimi jugosllav në Kosovë . . . . . » 59
Qëllimet e kolonizimit jugosllav . . . . . » 62
Rezultatet e kolonizimit jugosllav në Kosovë e në Metohi » 63
Pengimet e takuara nga kolonizimi jugosllav dhe reaksioni i elementit shqiptar . . . . . » 69
Anekse . . . . . » 73
Lumo Skendo: *Albanais et Slaves* . . . . . » 75
Jashar Erebara: *Fjalori Sërbisht-Shqip*, prej Ljuba Popa Kujunxhiq . . . . . » 83
Antonio Baldacci: *L'Albania* . . . . . » 85
Edmond Demolins: *Comment la route crée le type social* » 87
Justin Godart: *L'Albanie en 1921* . . . . . » 89
Carlo Tagliavini: *Le parlate albanesi di tipo Ghego-orientale (Dardania e Macedonia nord-occidentale)* » 95
Harold Nicolson: *Quand on faisait la Paix* . . . » 99
La Yougoslavie d'aujourd'hui . . . . . » 101
Urdhëri i Ministris së Drejtësis jugosllave me datë 4 Qershor 1938 . . . . . » 106
Pierre Loti: *Turquie agonisante* . . . . . » 107
Don Jean Bisak, Don Etienne Kurti et Don Louis Gashi: *La situation de la Minorité albanaise en Yougoslavie* » 109
Fletë propagande e djalëris kosovare . . . . » 113
Një ngjarje tragjike në Pejë (1938) . . . . » 117
Edith Durham: *Venti anni di groviglio balcanico* . . » 119
Bibliografi . . . . . » 127

PASQYRA E HARTAVE

Harta etnografike e Shqipërís, simbas J. J. Kettler-it . . faqe 32
Harta e banorëve të Kosovës me gjuhë amtare shqipen (botuar prej Qeveris jugosllave me statistikat e vitit 1921) » 40
Harta e banorëve muslimanë të Kosovës (botuar prej Qeveris jugosllave me statistikat e vitit 1921) . . . » 40
Harta e kolonizimit jugosllav në Kosovë, prej Besimtarit të Reformës Agrare jugosllave G. Krstiq . . . . » 68

PARATHËNËJE

Pak njerëz në Shqipëri e njohin Kosovën dhe krahinat e tjera shqiptare të veriut që traktatet ndërkombëtare u a kanë pas falur Malit te Zi dhe Sërbis më 1878 dhe më 1913; mund të thuhet se historija e Kosovës shqiptare dhe çështjet etnografike të saj janë në dijenin vetem të disa specialistëve. Librat mbi këto çështje nuk munguojnë, dhe sidomos në gjuhë të huaja ato formojnë një bibliotekë të pasur dhe provojnë shqiptarësin e krahinave në fjalë nga çdo pikëpamje. Mjafton të këndohen për këtë qëllim librat e dokumentat e botuara në ish-mbretërin jugosllave. Këto dokumenta pranojnë se shumica e popullsis në Kosovë është shqiptare, sadoqë përpiqen t'a fshehin ose t'a pakësojnë sasin e Shqiptarëve vënde vënde. Por ç'farë përfundimi do të jepte vallë një regjistrim i popullsis i kryer me paanësi të plotë? Sikur të realizohej do të ishte per né një dokument shum'i vlefshëm. Me gjithë këtë dokumentat e pregatitura prej sërbëve flasin mjaft në favorin t'onë dhe në këtë botim do të merren si themel sidomos dokumenta t'atilla. Për t'i plotësuar këto do të përdoren dhe botimet e të huajve që zakonisht kanë mbrojtur fqinjët t'onë të veriut gjer në një pikë sa që ata vetë e kanë gjykuar të tepëruar. Do të jepen si shëmbëll, në formë aneksesh në funt të këtij studimi, një sasi e vogël e vargut të pafundshëm të botimeve në gjuhë të huaja mbi shqiptarësin e Kosovës.

Por ajo që dihet më pak dhe që meriton të vihet në dukje është historija e Kosovës. Kosova nuk ka qënë vetëm djepi i rilindjes shqiptare, por ka qënë sidomos faktori kryesor i ngjarjeve historike që shkaktuan dhe siguruan krijimin e shtetit shqiptar dhe të liris s'onë kombëtare. Kosova ka qënë një fushë lufte e përherëshme ku Shqiptarët kanë derdhur gjakun e tyre shekuj me radhë në një luftë të dyfishtë kundër Turqve dhe kundër

Serbo-malazesve. Veçanërisht ngjarjet historike më me rëndësi, ato të periudhës se Lidhjes së Prizrenit (1877-1881) dhe ato të kryengirtjes së Kosovës (1909-1912), që patën si pasojë krijimin e shtetit shqiptar, ishin pothuaj kryekëput veprat e Kosovarëve. Vetëm Shqipëria e mbyllur në kufit e 1913-s pati fatin e mirë të gëzoje shpërblimin e therorive që bënë Shqiptarët e Kosovës, të cilët mjerisht, në vënd që të fitonin lirin e merituar, kaluan nga robërija turke në robërin sërbo-malazeze.

Me këtë rast e shoh për detyrë të falënderoj gjithë miqt që më ndihmuan në përpilimin e këtij botimi, dhe sidomos t'i shpreh mirënjohjen t'ime të thellë Zotit Rauf Fico për dokumentat që pati mirësin të më dorëzojë.

AUTORI

PJESA E I.

KONSIDERATA HISTORIKE

Ky studim ka për qëllim të japë, me anën e një përshkrimi historik dhe etnografik të shkurtër, një idé të përgjithëshme mbi ato krahina thjesht shqiptare të veriut dhe të veri-lindjes që ishin aneksuar prej Serbis e Malit të Zi pas luftës ruso-turke të vitit 1877 e pas luftës ballkanike dhe që në kohën e sundimit otoman bënin pjesë të vilajeteve të Shkodrës, të Kosovës dhe të Manastirit.

Në lëmën historike propaganda sërbe ka arritur mjerisht të bëjë çudira, sepse ka mundur t'a paraqesë Kosovën përpara opinionit të përbotshëm sikur t'ishte një vënd sërb. Në këtë punë vepra e propagandistëve sllavë ishte e përkrahur dhe prej ndihmës e bashkëpunimit të plotë të shtypit dhe literaturës së fuqive të mëdhà mbrojtëse të Sërbis. Propaganda shqiptare, me mjetet e saj tepër modeste, nuk ka pasur efektet e dëshërueshme sa do që dispononte argumenta më të forta dhe sa do që vetë realiteti fliste në favor të tezës shqiptare.

Një nga mjetet e propagandës sërbe ka qënë dhe folklora. Sërbët kanë egzaltuar në këngët e tyre popullore luftërat e tyre në Kosovë, por Shqiptarët kanë më shumë arësye se ata të jenë kryelartë për luftërat që kanë bërë kundër Turqve dhe kundër Sërbëve po në Kosovë, dhe këto vepra të lavdishme përmënden në këngët t'ona popullore, të cilat vetë Sërbët i kanë mbledhur dhe botuar në Beligrad, në rivistën *Prilozi Proncevanje narodne poezie* (1).

---

(1) Botimi në fjalë është një rivistë folkloristike sërbisht në të cilën gjënden shumë studime mbi folklorën e krahinave të ndryshme të Jugosllavis dhe posaçërisht gojëdhëna e vjersha shqipe të përkthyera në sërbishte ose të botuara në shqipe. Në këto studime këndonjësi takon shpesh herë shprehje shqipe si për shëmbëll: Bajraktar, kanga, cika, Dem Ahmeti, Ali Pashë Janina etj...

Në volumin e I të vitit të II, Mars 1933, nga artikulli i Sv. Stojaneviç, rezulton se gjer më 1500 nuk ka asnjë gjyrmë historike sërbe në Kosovë.

Në faqen 187 të numërit të II (viti 1934) po t'atij rivistë, është shkruar se rethet e Ohrit janë krejt shqiptare.

Po në atë numër në faqën 202, në artikullin e Dr. A. Urosheviç botohet

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS

Propaganda sërbe ka përdorur sidomos betejën e Kosovës (1389), të cilën e ka paraqitur si një mit të pavdekshëm të idealit kombëtar jugosllav dhe si argument për të justifikuar rivendikimet sërbe në Kosovë. Në fakt beteja e Kosovës, të cilën Sërbët e kanë përmëndur për së tepërmi duke i bërë të vetat të gjitha therorirat, ndodhi midis Turqvet dhe një koalicioni të krishterë nënë komandën e epër të mbretit sërb Lazar, i cili ra i vdekur në luft'e sipër.

Duhet pra të sqarohet mirë se beteja e Kosovës nuk ka qënë vepr'e Sërbëvet vetëm, por e një koalicioni të krishterësh të përbërë prej Sërbë, Shqiptarë, Bullgarë, Boshnjakë, Dalmatë, Ungarezë. Shqiptarët ishin të komanduar nga Princi Gjergj Kastrioti, gjyshi i heroit t'onë Skënderbej, por komanda e përgjithëshme i u-besua mbretit sërb Lazar, dhe kjo u-bë për shkak se asnjë nga ushtërit e tjera aleate nuk ishte komanduar nga një mbret dhe sepse ushtërija sërbe ishte më e madhja në numër.

Fuqit sërbe dhe ushtërit aleate që lëftuan në fushën e Kosovës u-përpoqën të ndalojnë invazionin turk me një shpeditë e cila kishte më shumë karakterin e një kryqëzate për t'i prerë, hovin rezikut mysliman se sa të një lufte me karakter kombëtar. Historianët e njohin këtë betejë si një kryqëzatë të ré kundra fuqis otomane që shtohesh dhe kërcënonte botën e krishtere të oksidentit.

Sidoqoftë fuqit shqiptare në këtë betejë sollën një kontribut të dorës së parë: « Më 1389 Gjergj II Ballsha, Theodor II Muzaka, Gjergj Kastrioti, stërgjysh i Skënderbeut, dhe disa princër shqiptarë të tjerë u-bashkuan me kralin Lazar të Serbisë, i cili organizoi një kryqëzatë

---

në gjuhën shqipe kënga e Dem Ahmetit, bashkë me përkthimin në sërbisht, kjo këngë refën trimërit e Dem Ahmetit në luftimet që ka bërë kundër Sërbëve në rethet e Mitrovicës.

Po n'atë numër në faqen 195, në artikullin e Tihomir P. Giorgevic thuhet se Shqiptarët kanë shumë gojedhëna, një sasi prej të cilave janë botuar n'atë numër të përkthyera në sërbisht.

Në faqen. 114, të numërit të I të vitit të IV (Mars 1935) thuhet se rethet e Kumanovës janë thjesht shqiptare dhe se elementet sllave që gjënden aty, janë kolonë të ardhur në vjetët e fundit.

Në këtë rivistë folkloristike gjënden në çdo fletë gjyrma karakteristike të egzistencës së elementit shqiptar në Jugosllavi, si në Mitrovicë, Shkup, Ohri, Drenice, në zonën e Gjilanit, në Kumanove etj... Janë botuar gjithashtu dhe fotografira shqiptarësh në kostumet dhe me instrumentin e tyre muzikal: lahutën.

Këto shënime janë nxjerrë nga rivista në fjalë prej studjonjësit D. Gjon Bizaku.

kundër Sulltan Muradit I. Ushtëria kryqësore, e përbërë prej Sërbësh, Bullgarësh, Bosnjakësh, Shqiptarësh, Vllehësh, Pollakësh dhe Hungarezësh u-përpoq me ushtërin turke në fushën e Kosovës. Në kësh-llën e luftës që u-mbajt nënë kryesin e kralit Lazar, Gjergj Kastrioti kishte proponuar që t'u bijen Turqve natën, po ky proponim nuk u-pëlqye nga shkaku që armiqt munt të shpëtonin nga një dishfatë e plotë e të iknin më t'errët (1). Il ranë pra ditën dhe u-dërmuan plotërisht prej Turqvet. Midis të vrarëvet ishin Sulltan Muradi I vetë dhe Teodor II muzaka (2). (*Historia e Skënderbeut*, prej Fan S. Nolit, Boston 1921, faqe 37).

Vetëm fati dhe rasti i solli Sërbët t'a zgjedhin Kosovën si fushë lufte, mbassi në realitet Kosova nuk ka qënë ndonjë here tokë sërbe e vërtetë dhe më von në rivendikimet e tyre Sërbët, para dhe pas luftës ballkanike, nuk kanë mundur të provojnë që krahina e Kosovës dhe krahinat e tjera shqiptare fqinje ishin sllave, dhe as që munt t'a provonin kur e aneksuan Kosovën, sepse numëri i Sllavëve ishte aty tepër i vogël.

Sa për shprehjen «Stara Serbija» d. m. th «Sërbija e Vjetër», që Serbët e përdorin zakonisht për të quajtur kështu Kosovën, duhet theksuar se ajo shprehje nuk ka asnjë bazë historike dhe se Sërbët e kanë çpikur vetë, nga mezi i shekullit XIX, për t'i shërbyer më mirë qëllimevet të tyre ekspansioniste në dëm të Shqipërisë. Këtë taktikë kanë përdorur dhe Bullgarët në propagandën e tyre me fjalën Maqedhoni e cila ka mbetur si një shprehje gjeografike që nga kohët e vjetëra kurse ata e kanë paraqitur Maqedhonin si një tokë iredente bullgare pa marrë parasysh egzistencën e elementevet etnike të tjera. Për shëmbëll Kaçaniku, Presheva, Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Kërçova, Dibra, Struga, Ohrija, paraqiten si pjesë të Maqëdhonis

(1) «Im feindlichen Kriegsrath war der Vorschlag, den Feind wahrend der Nacht anzugreifen, von Georg Castriota aus dem uebermuethigen Grunde verworfen worden, dass die Nacht die Flucht der Feinde begunstigend, sie ihr gaenzlichen Niederlage entziehen koenne». - Hammer-Purgstall, Geschichete des Osmanischen Reiches. (Vell. I, L. V. f. 177, ed. Peth, 1840. - Fan S. Noli. «Historia e Skenderbeut», faqe 33, Shenim 1).

(2) «Ma Lazaro Dispoto de Servia e Marco Re de Bulgaria e Theodoro Mosachi secondo genito de nostra casa et altri Signori d'Albania uniti insieme vennero alla battaglia (de Cossovo), e fur rotti i christiani, e ci morse il predicto Theodoro che portava seco grossa banda d'Albanesi». — Hopf, Muzaka, faqe 273. (Fan S. Noli: «Historia e Skënderbeut», Boston 1921, faqe 38).

bullgare, kufit e së cilës janë shënuar arbitrarisht dhe pa asnjë kriter etnik e gjeografik.

Këtë sistem ka përdorur në jugë dhe propaganda greke me fjalën Epir, e cila në realitet në dokumentat historike dhe letrare të vjetëra është sinonim i Shqipërisë, ashtu si fjala epirote tregon çdo gjë që është shqiptare ose ka të bëjë me gjuhën shqipe. Gjuha shqipe tregohesh me fjalët « gjuhë epirote » dhe Skënderbeu njihesh në kohët e kaluara si Princ i Epirit, kurse propaganda e fortë greke i ka shlyer këto gjyrma përpara opinionit të përbotshëm.

Para dhe pas luftës ballkanike shumë krahina shqiptare u-aneksuan prej Sërbis sa që munt të thuhet se një Shqipëri e dytë ekzistonte jashtë kufivet politike të Shqipërisë dhe kishte mbetur nënë sundimin e sërbëve. Të gjitha këto krahina quhen zakonisht në gjuhen shqipe « Kosovë », edhe kur bëhet fjalë për krahinat që janë shumë larg nga « Fusha e Kosovës ». Për sa i përket krahinës së Pejës dhe Jakovës ajo njihet prej nesh si pjes'e Kosoves, kurse emri i saj i vërtetë në shqipe është « Dukagjin ». Të huajt e tregojnë me emrin « Metohi », që rjedh nga greqishteja dhe do të thote pron'e kishës.

Për të forcuar konsideratat historike, duhet kujtuar se ngjarjet e zhvilluara në ato krahina shqiptare kanë një rëndësi të veçantë. Para ardhjes së Romanëvet dhe te Sllavëvet në Ballkan vëndi ka qënë në dorë të Illirianëvet, stërgjyshëvet të Shqiptarëvet, të cilët u-shquan sidomos me mbretërit e tyre në kohën e Teutes, me kryeqytet Shkodrën dhe me mbretërin e Dardanis, me kryeqytet Shkupin. Fiset dhe mbretërit iliriane treguan një gjallëri të madhe dhe okuponin pjesën më të madhe të Ballkanit perëndimor. Veçanërisht mbretërija e Dardanis që përfshinte gjith Kosovën dhe kishte Shkupin si qendrë, ka lojtur një rol historik me rëndësi. Kur Roma i okupoi vëndet e ilirianëve këta i ruajtin traditat dhe racën e tyre, ndërsa invazionet sllave që erdhën më von u-përpoqën t'i asimilojnë me çdo mënyre, duke u-ndruar gjuhën, zakonet dhe fen, si dhe duke u vënë emra sllave qytetëve dhe katundeve. Për këtë arësye gjejmë sllavë në Ballkan që ruajnë edhe sot karakteristikat e racës iliriane dhe u ngjasin me shumë Shqiptarëve se sa Sërbëve. Në disa zona, të ndodhura midis Sërbis dhe Kosovës shqiptare, popullsija nuk munt të dallohet me saktësi nëse është sllave a shqiptare mbassi flet të dy gjuhët dhe ka

tradita e zakone të përziera. Si do t'a shohim dhe më poshtë vetë Sërbët e pranojnë se shumë bashkëkombas të tyre e flasin sërbishten edhe sot me aksent shqiptar, gjë që provon origjinën shqiptare të këtyre popullsive. Fise shqiptare kanë humbur kështu egsistencën e tyre përpara invasionevet dhe propagandës sllave dhe janë sërbizuar. Kështu kemi shëmbëllën e fisevet shqiptare të Kuçit e të Piperit dhe të Plavës e Gusis që janë sërbizuar von; të atilla shëmbëlla kemi dhe në Novi-Pazar e në Senicë. Gjithashtu disa autorë janë të mendimit që populli malazes ka më shumë afinitet si racë me popullin shqiptar se sa me popullin sërb. Njerëz të shquar sërbë janë sot krenarë për origjinën e tyre shqiptare dhe i kujtojnë me mburje emrat e fisevet shqiptare nga të cilat rjedhin. (1).

Në rivendikimet e sllavëvet mbi tokat e Shqiptarëvet, argumenti kryesor është ay historik. Si Sërbët ashtu dhe Bullgarët i bazojnë të drejtat e tyre në ngjarjet e kohëvet mesjetare, kur ata popuj invaduan Shqipërin dhe Greqin dhe krijuan mbretërit e tyre që në realitet ishin më shumë perandorira sllave me karakter fetar që përpiqeshin me çdo mënyre të arrinin në Adriatik. Perandorit e këtyre popujvet sllavë patën të gjitha jetë të shkurtër dhe u-detyruan mandej të tërhiqen duke u lënë vëndësve të drejtën e vetëqeverimit dhe tokat që ishin përpjekur t'i kolonizonin. Një shëmbëll të këtillë e patëm dhe në shekullin t'onë me Jugosllavin, e cila në realitet ishte një perandori që donte të sundonte popuj të ndryshëm si Kroatët, Boshnjakët, Malazestë, Hungarezët, Rumunët, Maqedhonasit dhe Shqiptarët. Dëshira e sundimit arriti gjer në pikën sa të fillojnë një vepër kolonizimi në shkallë të gjerë në Kosovë, vepr'e cila në këtë shekull dhe në mes të Evropës ishte një ndërmarrje kundër çdo parimi njerëzor dhe qyteterimit të sotëm, sidomos po të mirren parasysh metodat me të cilat u-zbatua.

---

(1) ... Uno tra i più dotti albanologi viventi, il croato Milan Sufflay sostiene che quanto a usi e costumi, quanto a struttura sociale e quanto a modo di vivere non vi è alcuna differenza fra il popolo albanese ed il popolo montenegrino.....

Già nei secoli scorsi Albanesi e Montenegrini venivano considerati un popolo solo. Noi vedremo nelle pagine che seguono l'analogia profonda che esiste tra le due genti. Vialla de Sommières, l'inviato di Napoleone presso il Vladica Pietro I, scriveva nel 1820: « Sous le règne même du fameux Scanderbeg, les habitants du Montenegro étaient confondus sous celui général d'Albanais ». (Antonio Baldacci: « L'Albania », Roma 1929, faqe XX).

Rivendikimet dhe programet e tyre të kolonizimit Sërbët dhe Bullgarët përpiqen t'i justifikojnë me egzistencën e ndonjë kishe të mbetur nga kohët e kaluara dhe që kujton sundimin e shkurtër të mbretervet të tyre në Kosovë a në Maqedhoni, pa marrë parasysh se Shqiptarët janë popullsi autoktone dhe se më shumë se çdo popull tjatër e kanë vaditur këtë tokë me djersën e tyre dhe me gjakun që kanë derdhur në sa e sa kryengritje që kanë bërë kundra Sërbëve dhe Turqve.

Nga ana tjatër, për të qënë edhe më objektiv, munt të thuhet se invazionet e ndryshmë të Sërbëvet dhe të Bullgarëvet ne Ballkanin perëndimor dhe jugor hyjnë në kategorin e sa e sa invazionevet të tjera që pa Evropa dhe Ballkani në kohën mesjetare, me këtë ndryshim se Sërbët dhe Bullgarët zunë vënd në Ballkan për gjithënjë, por kjo nuk munt t'u lejojë t'u hanë të drejtën popujvet fqinjë dhe aq më pak popujvet autoktonë.

Passi Turqit pushtuan Ballkanin dhe sundimi i tyre u-stabilizua për afrò pesë shekuj resht, Shqiptarët jo vetëm nuk u-asimiluan prej sunduësit të ri por e forcuan pozitën dhe racën e tyre. Në fillim të pushtimit të Ballkanit Turqit rezistencë më të fortë e gjenë në popullin shqiptar i cili e vazhdoi luftën afro një shekull, për një kohë më të gjatë dhe në një mënyrë më të shkëlqyer se sa popujt e tjerë të Ballkanit. Sidomos rezistenca e vazhduar dhe e pathyeshme e Skënderbeut u-a mbushi mënden Turqvet se kishin të bënin me një element të shëndoshë, të cilin u-përpoqën t'a asimilonin vetëm nga pikëpamja fetare dhe t'a mbanin të gjallë si racë, në mënyrë që populli shqiptar u-bë një shtyllë rezistence kundër rezikut sllav. Popujt sllavë, sado të mposhtur vazhdonin ekspansionizmin e tyre në dëm të popujvet të tjerë fqinj. Sikur Shqiptarët mos të kishin marre fenë muslimane, do të ishin asimiluar krejt nga Sllavët; kështu vetëm disa fise u-asimiluan kurse shumica shpëtoi. Shqiptarët e Kosovës, që ishin si pararoja e racës, zhvilluan kështu një luftë të dyfishtë dhe shekullore kundër sundimit turk që përpiqesh t'i mposhte sa më shumë dhe kundër infiltracionit dhe veprës së asimilimit që zhvillonin sllavët me anën e fes dhe të propagandës.

Kundër Turqvet që përpiqeshin t'i mposhtnin edhe më tepër, Shqiptarët ngrinin krye herë pas herë, gjë që provohet nga të pesëdhjet'e

katër lëvizjet kryengritëse shqiptare që regjistron historija turke, nga të cilat ajo e vitit 1668, që plasi në Mitrovicë, dallohet sidomos sepse muarnë pjesë në 'të gjithë Kosovarët. Kjo lëvizje u-shtri përtej Shkupit dhe kërcënoi rrugën e Selanikut (Taarih - Eb yl - Farruuk, faqe 13).

Prapë në Kosovë ndodhen më von ndërmarrjet për ringjalljen e Atdheut shqiptar.

Fakti historik që e filloi rilindjen shqiptare ndodhi në gjirin e vilajetit të Kosovës, në Prizrend, ku u-themelue lidhja e famëshme e njohur me emrin Lidhja e Prizrenit (1878). Nga Kosova filluan të zhvillohen degët e kësaj organizate madhështore që si një shkëndijë u-përhap nënë shtytjen e ndjenjës kombëtare në të gjitha anët e Shqipëris. Kosovarë ishin elementet kryesore të Lidhjes që e vunë në zbatim programin e mbrojtjes së interesavet shqiptare duke lëftuar kundra Malazesve, Sërbëve dhe Grekërve.

Krijimi i Lidhjes u-shkaktua nga traktati i Shën Stefanit (1877) i cili u-rishikua mandej në Berlin. Krerët shqiptarë të ardhur nga të gjitha anët e Kosovës dhe të Shqipëris për të marrë pjesë në mbledhjet e Lidhjes në Prizren vendosën: të shpëtojnë sidomos Atdheun nga copëtimi i dekretuar nga Kongresi i Berlinit në favor të kombeve fqinj; se dyti t'i imponojnë Qeveris otomane autonomin e Shqipëris brënda kufivet administrative të katër vilajeteve të Janinës, Manastirit, Shkupit dhe Shkodrës, me Ohrin si kryeqytet, e më në funt ta pregatitin kombin për luftën e fundit, për pamvarësin e tij të plotë.

Përveç kësaj Lidhja dërgoi në kongresin e Berlinit delegatët e saj, por desideratat e tyre as që u-dëgjuan, mbassi në ate mbledhje nuk kish njerëz që të tregonin dëshirë të mirë për të evituar të këqijat që i rezervoheshin Shqipëris.

Kështu u-vendos në atë Kongres copëtimi i tokavet shqiptare për të kënaqur lakmit sërbe, malazese dhe greke. Por vullneti i Shqiptarëvet të armatosur nuk u-përkul prej këtij vendimi të padrejtë; për të ruajtur integritetin tokësor shqiptar, Lidhja kundërshtonte me të gjitha fuqit dhe me rezistencën e saj krenare. Fuqit shqiptare lëftuan burrërisht në Plavë e Gusi dhe i shpëtuan ato krahina nga zgjedha malazese. Ashtu lëftuan në Hot dhe në Grudë si dhe në Ulqin ku Evropa u-detyrua të dërgojë një flotë ndërkombëtare për të kërcënuar Shqi-

ptarët dhe nga ana tjatër e shtrëngoi Sulltanin të bëjë një shpeditë për të dënuar kryengritësit shqiptarë që kishin vendosur më mirë të vdisnin se sa të lëshonin një pëllëmbë tokë të vëndit të tyre.

Rezistenca e organizuar e Lidhjes së Prizrenit u-solli për dy vjet me radhë shumë pengime Fuqive të Mëdha dhe Turqis vetë dhe përgënjeshtroi mendimin e atyre që pretendonin se Lidhja ishte një krijesë dhe një lodrë e Qeveris së Stambollit. Turqija mundi t'i dorëzonte Malit të Zi Podgoricën dhe Shpuzën, por kur erdhi puna për dorëzimin e Plavës dhe Gusis, fuqit shqiptare e kundërshtuan me armë. Si Mali i Zi ashtu dhe Qeverija e Stambollit nuk guxonin të përdornin forcën dhe çështja i u-besua një komisioni ndërkombëtar për caktimin e kufirit në vënd. Por Lidhja i drejtoi komisionit një ultimatum me të cilin njoftonte se nuk munt të njihte asnjë vendim të marrun pa pëlqimin e saj.

Me gjithë kërcënimet që bënte, Mali i Zi nuk kishte mjaft fuqi për të filluar një vepërim kundër Shqiptarëve dhe Turqija vetë nuk munt të përdorte forcën sepse populli shqiptar ishte ndezur gjer në pikën sa vrau Mehmet Ali Pashën në Jakovë dhe nga ana tjatër fuqija shqiptare sa vente po shtohej dhe organizohej.

Mbi ndërhyrjen e Italis u-arrit në një regullim të ri: në vënd të Plavës dhe Gusis u-vendos t'i jepej Malit të Zi Triepshi, Hoti Gruda dhe Klementi, të banuara me populsi shqiptare katolike. Mirëpo Shqiptarët katolikë, të bashkuar me bashkëkombasit e tyre muslimanë çfaqën kundërshtimin e tyre për dorëzimin e këtyre vëndeve Malit të Zi, ndërsa Prenk Bib Doda, në krye të 10 mijë Mirditasve dhe Malësorëve prej fisesh të ndryshme u-pregatit t'u vinte në ndihmë.

Përpara këtij qëndrimi të patundur të Shqiptarëve, Fuqit e Mëdha u-detyruan të marrin një vendim të tretë: dorëzimin e Ulqinit Malit të Zi. Po dhe në këtë rast Shqiptarët çfaqën kundërshtimin e tyre dhe pa humbur kohë zunë pozitat mbi kodrat reth Ulqinit. Por këtë herë puna dukej më e lehtë për Fuqit e mëdha sepse këto vendosën të bëjnë një demostrasion detar duke dërguar në Ulqin një flotë ndërkombëtare për të siguruar dorëzimin e qytetit. Me gjithë këtë dhe këtë herë përfundimi dukej i dyshimtë sepse vetë Ambasadori i Francës në Stamboll, në një letrë drejtuar Qeveris së tij më 27 Gusht 1880, shprehesh me këto fjalë: «Sjellja e Shqiptarëvet është në një shkallë sa që Qeverija turke nuk ka besim në vetëhen e saj

e s'ndodhet në gjëndje për t'u-zotuar në një dorëzim tokash, për të cilën Liga Shqiptare nuk konsenton. Liga Shqiptare më shumë se kurdoherë duket më pak e dispozuar për të lënë copa të tokës shqiptare. Edhe Porta e Naltë as që do t'a shtrëngojë me forcë (1) ».

Edhe popullsija e Ulqinit u çfaqi me shkresë Fuqive të mëdha keq-ardhjen dhe kundërshtimin e saj për dorëzimin e qytetit Malit të Zi dhe në bashkëpunim me organet e Lidhjes filloi të organizohej për një rezistencë të armatosur. Flota ndërkombëtare, që ardhi afër Ulqinit për të kryer detyrën e saj, u-shtrëngua të qëndrojë dy muaj pa arritur asnjë rezultat. U-desht të vinin fuqit e dërguara prej Sulltanit të cilat pas një luftimi me Shqiptarët arrijtin të kryejnë dorëzimin e qytetit Malit të Zi më 26 Nëntor 1880, ngjarje të cilat u-konstatuan dhe prej flotës që qëndronte në ujërat e Ulqinit prej dy muajsh.

Po në atë kohë Hodo Pasha një nga krerët e Lidhjes dhe Bib Doda, kryetari i Mirditasvet që ishte solidarizuar më parë me Shqiptarët që kishin vendosur të kundërshtonin me armë dorëzimin e Triepshit, Hotit, Grudës dhe Klementit, u-kapën prej Turqvet të cilët me një anijë-lufte i dërguan në mërgim, dhe Oroshit, kryeqëndër e Mirditës, i vunë zjarrin.

Vlen të shënohet se në kohën e Kongresit të Berlinit disa burrave shteti englezë u ishte mbushur mëndja të perkrahnin tezën e të drejtavet të Shqipëris kundër lakmivet të Sërbëve dhe Malazesve dhe të mendonin që atë herë për krijimin e një provincë të madhe shqiptare të përbërë prej katër vilajeteve: të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës (2). Midis së tjeravet nxjerrim një pjesë të një letre të Ambasadorit englez në Stamboll Lord Goshen drejtuar Ministrit të Jashtëm me 26 korrik 1880: « Si une Albanie forte était constituée, les motifs d'occupation par une puissance étrangère, en cas

(1) Mehdi Frashëri: « Liga e Prizrenit edhe efektet diplomatike të saj », Tiranë 1927, faqe 30. Për hollësira të tjera mbi këtë periudhë të rëndësishme të historis së Shqipëris vëlejnë të shqyrtohen dhe « Lidhja e Prizrenit », prej Xhafer Belegut (Tiranë 1939), dhe botimet e posaçme të rivistës « Leka » (Shkodër 1938-1940) që kanë nxjerrë në dritë shumë dokumenta historike të asaj kohe.

Shih dhe Antonio Baldacci: « L'Albania », Roma 1929, faqe 139-140.

(2) Shih në « Albanais et Salves », prej Lumo Skendo-s, pjesët e nxjerra nga « L'Albania et la question d'Orient » prej Princit Albert Ghica, Paris 1904, dhe nga « Libri i Kaltërt » englez mbi çështjen shqiptare.

de dissolution de l'empire ottoman, disparaitraient. Une Albanie barrerait le chemin au Nord et maintiendrait la péninsule balcanique entre les mains et sous l'autorité de ceux qui l'occupent. Autrement la puissance des Albanais constituerait une difficulté insurmontable au moment où des troubles surgiraient. Une population en grande partie musulmane serait une source de grande difficultés pour les contrées slaves et grecques qui l'envahiraient. Je considère que la probabilité de l'intervention européenne dans la péninsule balcanique diminuerait en proportion de l'établissement de la nationalité albanaise ».

Problemi shqiptar nuk munt të përcaktohesh më mirë por mjerisht të gjitha këto mendime dhe dokumentat e tjera përkatëse u-mbuluan nga pluhuri i arkivave zyrtare dhe kur u-riçel çështja shqiptare në raste të tjera, sidomos në kohën e luftës ballkanike dhe në konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, nuk u-muarrën parasysh.

Dihet se mbretëris sërbe Kongresi i Berlinit i dhuroi Nishin, Leskovacin, Prokupljen, Kurshumlin dhe Vranjën, krahina që n'ato kohë ishin të banuara në shumicë prej Shqiptarësh, kurse sot shumica e popullsis së tyre është sërbe për shkak të infiltracionit sllav. Por sërbët ahere të pakënaqur nga sa u falte Kongresi i Berlinit sepse lakmia e tyre vente duke u-shtuar, sulmuan tokat shqiptare më të afërme në jugë dhe arrijtin në portat e Prishtinës, në grykat e Kulinës, ku mbassi u-përpoqën me disa fuqi të pakëta shqiptare që arritin në vënd, u-dërmuan dhe u-shtrënguan të tërhiqen drejt vijës që u-kishte caktuar Kongresi.

Përpjekjet e Shqiptarëve dhe luftërat heroike të tyre në kohën e Lidhjes së Prizrenit përbëjnë epopén shqiptare që poeti kombëtar At Gjergj Fishta e bëri të pavdekëshme në poemin e tij « Lahuta e Malcis ».

Veprimtarija e Lidhjes nuk mbaroi me kaq: epizodi më i shquar i asaj periudhe ndodhi në funt me rastin që u-muarrën masat e duhura për t'i siguruar Shqipëris autonomin e saj. Ngjarjet u-zhvilluan sidomos në Kosovë dhe me gjithë se përpjekjet e Shqiptarëve dështuan dhe u-shtypën prej fuqive turke, vëlejnë të vihen në dukje më

shumë se të gjitha ngjarjet e tjera të asaj kohe sepse formojnë një dokument historik të vlefshëm që provon vullnetin e popullsis së Kosovës për liri dhe për pamvarësin e Shqipëris.

Lidhja kishte pregatitur sheshin me kohë për të bërë një mbledhje të përgjithëshme në të cilën do të mirrin pjesë përfaqësuesat e të gjitha krahinave shqiptare për të kërkuar zyrtarisht nga Sulltani autonomin e Shqipëris. Me rastin e kësaj mbledhjeje qëndra e Lidhjes u-transferua përkohësisht nga Prizreni në Dibër me qëllim që të luftonte aspiratat e Bullgarëve në Maqedhoni dhe lëvizjet e komitave të tyre që atëhere kishin filluar të vepëronin në lindje të Shkupit dhe në Përlep.

Në Tetor 1880 pesëmijë përfaqësuesa të ardhur nga të gjitha krahinat shqiptare u-mblodhën në Dibër dhe midis së tjerave vendosën të kërkonin zyrtarisht nga Sulltani autonomin e Shqipëris etnike.

Prëmtimet e bëra më parë prej Sulltanit në raste të ndryshme kryetarëve shqiptarë nuk po zbatoheshin, prandaj Lidhja duhesh të vepëronte pa humbur kohë. U-caktua si kryeqytet Ohri dhe u-vendos që krahinat e Shqipëris etnike autonome të administroheshin nga nëpunësa shqiptarë, me gjuhë zyrtare shqipen dhe me shkolla shqipe në të gjitha viset. Njëkohësisht u-muarrnë masa për të lëftuar çetat bullgare.

Kërkesat e mbledhjes i u-paraqitën Sulltanit, por mbassi mbetën pa përgjegje Lidhja mori inisiativën dhe filloi të vinte në zbatim programin e vetë duke dbuar prefektët e emëruar nga Stambolli dhe duke i zëvëndësuar këta dhe nëpunësa të tjerë me njerëzit e saj. Kështu u-dbuan prefektat e Shkupit dhe të Dibrës; dhe valiu i Prishtinës, i kërcënuar nga fuqit shqiptare, u-aratis. Mbassi shpërndanë disa nga garnizonet turke dhe muarrnë dhe municione, fuqit shqiptare e shtrijtin autoritetin e Lidhjes në Shkup, Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Dibër, ndërsa Jakova, Luma dhe të tjera krahina i bashkuan fuqit e tyre me ato të Lidhjes. Në Shkup dhe në Prizren garnizoni turk u-mbyll në fortesë dhe populsija shqiptare lidhi besën që të bashkohesh me Lidhjen.

Përpara kësaj gjëndjeje Sulltani u-ndodh shumë ngushtë dhe nuk dinte se ç'vendim të merrte: të zbatonte premtimet për autonomi të bëra më parë Shqiptarëve, apo t'a çdukte Lidhjen me forcë mbassi reziku i jashtëm për Turqin ishte shuar përkohësisht. Shumë nga

njerëzit e rethit të tij e kështillonin për vëndimin e dytë dhe kështu u-bë. Më 25 Mars 1881, një ushtëri turke e armatosur mirë me mjete moderne dhe e komanduar nga Dervish Pasha arrinte nga Selaniku në Shkup, ku u-arestuan me një herë shumë anëtarë të degës së Lidhjes në atë qytet dhe u-dërguan në Selanik prej ku më von u-përcollë për internim në keshtjellën e Rodosit. Mandej Dervish Pasha dha urdhër për të pushtuar gjithë hekurudhën Shkup Mitrovicë.

Mbi këtë, Lidhja i dha kushtrimin Kosovës dhe fuqit shqiptare u-grumbulluan në krahinën e Stimljes, midis Prishtinës dhe Prizrenit. Në përpjekjen që ndodhi atje, fuqit shqiptare përpara forcave ushtarake turke të armatosura mirë u-detyruan të tërhiqen duke lënë 300 të vrarë dhe të plagosur. Pas pak kohë ushtërija turke shkoi në drejtim të Prizrenit, Jakovës dhe Pejës, ku mori masa kundra udhëheqësve të fuqive shqiptare dhe kundra drejtuësave të Lidhjes, prej të cilëve një pjesë u-arratisën, disa u-internuan dhe disa të tjerë u-mbajtën si peng me qëllim që t'i pritesh hovi ndonjë sulmi që munt të bënin malësit (1).

Me gjithë këtë Lidhja e Prizrenit pati më von një periudhë ringjalljeje dhe filloi rishtaz nga veprimtarija në Pejë, ku më 1899, në një mbledhje në të cilën muarrën pjesë krerët shqiptarë për të kundërshtuar kërkimet dhe lakmit e fuqive ballkanike fqinje, u-vendos: a) mbrojtja e tokave të Sulltanit nga çdo grabitje; b) kundërshtimi për çdo ndryshim në administrimin e Maqedhonis. «Katër vjet më von (1903) u-bë një protestë simbas bisedimeve dhe vendimeve të Pejës kundër projekteve austro-ruse për reforma në Maqedhoni dhe me këtë rast tremijë Shqiptarë të Kosovës ngritnë krye dhe vranë për raprezalje Konsullin e Rusis Scherbinë në Mitrovicë». (Antonio Baldacci: *L'Albania*, faqe 141). Në realitet vrasja e konsullit të Rusis ndodhi sepse ay kishte marrë pjesë në luftimet kundër Shqiptarëve.

Duhen përmëndur më në funt luftërat e Shqiptarëve kundër (1)

---

(1) Për hollësira të tjera mbi këto ngjarje shih kapitullin e fundit në: «Lidhja e Prizrenit» prej Xhafer Belegut.

(1) Në lidhje me këto ngjarje vlen të hidhet një vështrim në librin e shkrimtares engleze Edith Durham «Venti anni di groviglio balcanico» për-

Turqis gjatë periudhës 1908-1912, nga të cilat beteja e Kaçanikut (1910) dhe fitorja që i shpuri kryengritësit shqiptarë, nënë udhëheqjen e krerëve të tyre Isa Buletini, Hasan Prishtina dhe Azem Bejto, në qytetin e Shkupit dhe gjer në Veles (1912), dëshmojnë vulnetin e pathyer të Shqiptarëve që të realizojnë indipendencën e Atdheut të tyre me integritetin tokësor të Shqipëris. «Në 1909, fiset muslimanë të Kosovës ngritën krye duke marrë si shkak pagimin e taksave dhe vetëm në funt të tetorit kryengritja dukej se u-mposht nga forcat e mëdha turke. Luftimet u-zhvilluan sidomos në distriktin e Lumës, ku Isa Boletini udhëhiqte Rebelët. Më 1910 të tjera fise të Kosovës ngritën krye po për atë arësye; gjatë shtinës së verës 50 mijë ushtarë të regullтë turq mezi mjaftuan për të çarmatosur popullsin. U-shkatëruan katunde të tëra dhe u-kryen gjithë atrocitetet në të cilat Turqit dinë të tregojnë zotësi, por Shqiptarët u-betuan që të çpagonin në Turqit vuajtjet që këta u kishin shkakëtuar komandantëve të rebelëvet» (A. Baldacci: l'*Albania*, faqe 143). Dhe në Shqipërin e mesme dhe të jugës shpirtërat ishin ndezur kundër Turqis, por aty më shumë se sa për taksat, pakënaqësija vinte nga ndalimi i mësimit të gjuhës shqipe, sepse Turqit e Rinj mbyllën shkollat shqipe

---

kthyer dhe botuar në italisht më 1923 (Firence), libër i cili është një histori e vërtetë e ngjarjeve të Shqipëris dhe të Ballkanit përgjithërisht në fillim të këtij shekulli. Midis së tjerave shkruan:

«Gli Albanesi di Kossovo insorsero. Ancora Isa Boletin si pose alla loro testa, e li condusse di vittoria in vittoria fino alla presa di Uskub. I consoli esteri attestarono che in Uskub la condotta delle truppe albanesi fu esemplare.

«Poichè gli Albanesi vittoriosi accennavano di marciare su Monastir, i Turchi chiesero una tregua, riconobbero i quattro vilayet di Janina, Scutari, Kossovo e una parte di Monastir come provincia albanese autonoma.

«Fu rovesciato allora il Governo Giovane-Turco, e a Costantinopoli tenne il potere un gabinetto più moderato.

«Ma erano gli stati balcanici quelli che avevano progettato di prendersi ciascuno una porzione d'Albania; su ciò erano d'accordo più che mai, e la Russia approvava. Sicchè essi pensarono di dover subito assalire il popolo albanese, prima che non fosse riescito a consolidarsi. «Delenda est Albania!», e affrettarono i preparativi di guerra». (faqe 267).

«Iniziando le ostilità, il Montenegro sperava di occupare tutti i distretti compreso Prizren, prima che i Serbi fossero pronti. La Bulgaria doveva trattenere i Turchi, poi Nicola e Ferdinando si sarebbero divisa la penisola.

«Ma i Serbi presero loro Prizren, facendo accorto il Montenegro de' suoi errori di calcolo. Era da sapere che una guerra balcanica senza la Russia imponeva a tutti gli Stati della penisola di non restar neutrali. I piani montenegrini dunque fallirono. Gli stessi loro successi iniziali erano dovuti ai Malissori. Ma quando, imbaldanziti, i Montenegrini presero a trattare il territorio albanese come conquista, e i Malissori insorsero loro contro, fu subito altra faccenda. I Malissori buttarono il berretto montenegrino, si ritrassero

që më parë ishin lejuar simbas programit liberal të çpâllur prej tyre. Politika e Turqvet të Rinj ishte ndryshuar dhe ishte bërë më e reptë se ajo e Sulltan Hamidit: qëllimi i kësaj politike të rè ishte që të turqizonte me forcë popullsit jo turke të Perandoris otomane. Pas shpeditës, me forca të konsiderueshme që bëri Turgut Shevqet Pasha në muajin prill kundër Malësivet të Shkodrës ku pësoi mjaft dëme, në muajin Maj bashkoheshin dhe Mirditasit me rebelët dhe proklamonin autonomin e tyre duke emëruar një qeveri provizore. Një komitet qëndror shqiptar ishte formuar dhe kërkonte që gjithë vëndet shqiptare të përmblidheshin në një vilajet të vetëm, që shkollat shqipe të mbaheshin prej shtetit dhe që milicia shqiptare në kohë paqe duhesh të bënte shërbimin ushtarak në tokë shqiptare. Vijonin dhe njëmbedhjetë pika të tjera për të cilat shqiptarët kërkonin zbatimin nga ana e Turqis: njohja e kombësis shqiptare, përdorimi i gjuhës shqipe në shkollat dhe në administratën lokale, garancira të ndryshme mbi funksionimin e administratës në Shqipëri, pagimi i dëmevet të kryera nga ushtërit e operasioni kundër kryengritësve, dënime kundër fajtorëvet, çlirimi i të dënuarvet politikë etj... Nga frika e një ndërhyrje nga ana e të huajvet qeverija e Stambollit i dha urdhër Turgut Pashës që t'u bënte koncesione Shqiptarëvet, koncesione të cilat në realitet mbenë të pazbatuara. Në fillim të vitit 1912 qeverija turke përpiqet t'i marrë Shqiptarët me të mirë dhe dërgon në Shkodër ministrin e brëndëshme për t'u-marrë vesh me Shqiptarët për reformat që munt të bëheshin në Shqipëri, por Shqiptarët as që afrohen. Malësorët dhe Mirditasit fillojnë të levizin rishtaz dhe kryengitja përhapet gjer në Kosovë ku merr proporcione të jashtëzakonëshme. Kryengritësit passi marrin Prishtinën. drejtohen për në Shkup dhe arrijnë gjer në Veles duke kërcënuar kështu rrugën e Selanikut. Përpara këtyre ngjarjeve qeverija turke përunjet, shpërndan parlamentin, u premton autonomin Shqiptarëvet dhe pranon të trembëdhjetë pikat e kërkesave të tyre. Në ato

---

e chiesero a me se assalire i montenegrini alle spalle, o tagliarli fuori dalle loro basi. Io li pregai a scartare l'una e l'altra idea, perchè credevo ancora nell'onestà delle grandi potenze, e speravo si sarebbe resa giustizia all'Albania. Ma oggi deploro il mio ingenuo consiglio». (faqe 272-273).

Përveç ngjarjeve historike, libri në fjalë përmban përshkrime etnografike si dhe përshkrime mbi veprën e çkombëtarëzimit të kryer nga shtetet ballkanike kundër elementit shqiptar.

kohë çështja bëri bujë të madhe, i hapi sytë botës dhe i detyroi të huajt të njohin realitetin: « Les Arnautes quatre années durant résistent, guerroient,. reculent, reviennent et au jour favorable entrent victorieux sur cette place du Konak (Uskub) où ils installent leur chef ». (Gabriel Louis-Jaray: *Au jeune Royaume d'Albanie*, Paris 1914, faqe 189).

Koalicioni i fuqive ballkanike që ndiqte me vërejtje zhvillimin e gjëndjes nuk e shihte me sy të mirë krijimin e një Shqipërije autonome e cila do t'u pakësonte pjesët që do t'u takonin kur të copëtohesh Turqija e Evropës midis tyre. Disa muaj më vonë aleatët ballkanikë hynin në fushën e luftës kundër perandoris otomane dhe arësyet e kësaj ndërmarrjeje luftarake kanë qënë, siç e pohojnë vetë të interesuarit, dobësimi i Turqis nënë grushtet që i kishin hequr kryengritjet shqiptare dhe frika e krijimit të një Shqipërije të lirë me kufit e saj etnike. « Ministri bullgar Gjecov pranon në veprën e tij *l'Alliance Balcanique* se kryengitja shqiptare ka qënë shkaku determinonjës i koalicionit dhe i luftës që u-fillua kundër qeveris fatzeze të Komitetit « Bashkim e Përparim »: orvajtja shqiptare, shkruan ay, kishte nxjerrë në shesh dobësin dhe pazotësin e tij.

Kështu kryengritjet dhe luftërat e Shqiptarëvet që për pak i siguruan indipendencën Shqipëris etnike që më 1912, përfunduan në dobi të shtetevet të tjerë ballkanikë, të cilët kur filluan luftën e tyre kundër Turqis e gjetën sheshin të pregatitur për një fitim të shpejtë dhe të sigurtë, dhe kontributi që kishin dhënë Shqiptarët për rëzimin e sundimit otoman në Ballkan shkoi në dobi të fuqivet ballkanike aleate. Kjo gjëndje u-konstatua atëherë dhe nga të huajtë dhe prandaj këtu i a lëmë më mirë fjalën Antonio Baldacci-t i cili më 1913 në botimin e tji *Il nuovo stato d'Albania*, faqe 16, shprehesh me këto fjalë: « Una narrazione imparziale potrebbe chiaramente provare che gli ostinati e sanguinosi combattimenti degli Albanesi per la libertà contro la centralizzazione Giovane-Turca (1909-1912) formano una delle vere cagioni dei grandi e rapidi progressi di guerra degli Alleati. Ciò dovranno sempre ricordare con gratitudine i popoli balcanici perchè sono stati gli Albanesi che hanno fatto la fortuna degli altri ».

Duhet theksuar nga ana tjatër se Manastiri dhe Shkupi ishin berë qendrat e propagandës për çlirimin e kombit, në Manastir

u-mblodhën kongreset e para të gjuhës shqipe (1908), ndërsa qendrat e shoqatës Bashkimi për mësimin e gjuhës shqipe u-përhapën në të gjitha qytetet e Kosovës pas shpalljes së Hyrijetit (1908). Gazeta e rivista në gjuhën shqipe botoheshin në Shkup e në Manastir.

Lëvizja shqiptare zgjojti ahere kureshtin dhe interesimin e të huajvet dhe «Albanian Committee» në Londër paraqiti më 1913 në Konferencën e Ambasadorëve një hartë të Shqipëris etnike që i afrohet mjaft vijës etnike të vërtetë. Materiali për një punë të këtillë nuk mungonte sepse shumë studioza ishin marre me çështjen që më parë dhe kishin botuar harta etnografike të ndryshme që me gjithë mungesat dhe të metat e tyre deri diku plotësojnë njera jatrën. Këto harta janë riprodhuar në librin e Lumo Skëndos *Albanais et Slaves* (Lausanne 1919) dhe në botimin *Les Bulgares dans leurs frontières historiques, ethnographiques et politiques* (Berlin 1917) prej D. Rizoff.

Një hartë etnografike e vlefshme është dhe ajo e Prof. Dr. J.J. Kettler, botuar në Berlin më 1919.

PJESA E II.

KONSIDERATA ETNIKE

Nga pikëpamja etnike, popullsia e krahinavet shqiptare që kishte aneksuar ish-shteti jugosllav, është kompaktësisht autoktone shqiptare, dhe as që meriton t'i atribuohet ndonjë rëndësi numërit fare të vogël Sllavësh (Sërbë, Malazes, Maqedhonas) të infiltruar gjatë sundimit otoman, i cili siç dihet mbyllte syt përpara këtij infiltrimi, për arësye të ndryshme, mbassi traditat ushtarake të perandoris otomane ishin bërë shkak që shtetasit prej feje muslimane e kishin lënë mbas dore pak nga pak çdo aktivitet tregëtar dhe industrial me të cilin merreshin me shumë elementet e krishterë të asaj Perandorie. Nga ana tjatër infiltrimi i elementeve sllavë në Kosovë e në krahinat e tjera shqiptare favorizohej dhe nga fakti që pronarët shqiptarë thrisnin bujq sllave dhe i sillnin nga vënde të larga për të punuar tokat e tyre, kurse katundarit shqiptar i pëlqente më shumë të rinte zot në tokën e tij ose të shkonte ushtar. Popullsija shqiptare, për shkak të thirrjeve të shpeshta nënë armë dhe luftërave të brëndëshme për ahmarrje, pësonte pakësime që pronarët dhe autoritetet i zëvëndësonin me katundarë dhe bujq sllavë, të cilet ishin më puntorë e të qetë dhe nuk kishin detyrime ushtarake.

Me gjithë keto infiltrime të elementeve sllave, egzistonte në kohen e perandoris otomane një Shqipëri etnike ku shumica dërmuese e popullsis ka qënë kurdoherë shqiptare. Kjo Shqipëri etnike, me gjithë që nuk kishte asnjë karakter politik ose administratif më vetëhe, ruante një fizionomi thjesht shqiptare dhe kompakte kundër kërcënimevet dhe penetrasionit sllave, dhe e siguronte integritetin e vetë me një mbrojtje strategjike të vërtetë: është për të shënuar se në krahinat periferike të kësaj Shqipërije etnike, katundet shqiptare gjënden nëpër male e gryka dhe janë vendosur nëpër pozita natyrale të sigurta për t'u-mbrojtur më mirë nga invazionet e sllavëve. Ky fenomen munt të shihet në krahinat e Shkupit, Kumano-

vës, Preshevës, Podujevës, Mitrovicës, Pejës, Peshterit etj..., të cilat përbëjnë një mbrojtje strategjike të vërtetë reth fushës së Kosovës dhe Dukagjinit (Metohis).

Në fenomenin e këtyre infiltrimevet sllave që shoqëroheshin edhe me politikën e assimilimit e sllavëzimit të elementit shqiptar me anën e propagandës fetare e me mësimin e gjuhëvet sllave dhe toleroheshin prej Perandoris otomane, Rusia cariste zbuloi bash mjetin politik më të mirë për të përhapur iden pansllave ndëpërmjet të krijimit të shtetevet të krishterë në Turqin e Evropës, të cilët mandej do të përpiqeshin me çdo mënyrë per ta tronditur Turqin me qëllim që ta dbonin nga Ballkani. Krijimi dhe smadhimi i shtetevet ballkanikë të lidhur mbas qeres së Rusis cariste fatalisht do ta sillte punën gjer në copëtimin e tokavet thjesht shqiptare.

Me gjithë këtë elementet sërbe e malazese të infiltruara gjer më 1912 në krahinat shqiptare që më von do të aneksoheshin nga Jugosllavia, nuk përfaqesonin vecse 5% të popullsis së përgjithëshme, por çka meriton të vihet në dukje është fakti se në krahinat në fjalë, sidomos në veri të distriktevet të Shkupit, Kumanovës dhe Tetovës, Gostivarit e Kërçovës, as para as pas vitit 1912, nuk figuron asnjë element bullgaro-maqedhonas. Por dhe n'ato vise shqiptare si Shkupi, Tetova, Gostivari, Kërçova, Struga, Ohri, Manastiri, ku elementi Maqedhonas ka mundur të infiltrohet para vitit 1912, numëri i tij ka qënë kurdoherë pa rëndësi në krahasim më numërin e Shqiptarëvet.

Nga pikpamja etnike krahinat e jona që ishin aneksuar prej Jugosllavis, paraqiten në mënyrë të padiskutueshme me një fizionomi krejt shqiptare. Kjo ka qënë dhe është e ditur prej të gjithëve, dhe as që do t'ishte nevoja të jepen prova. Mjafton vetëm të radhitim këtu poshtë, më qëllim që të japim një dokumentim të shkurtër dhe në një formë sa më të përmbledhur përshkrimin etnografik të këtyre viseve.

Katër lloj dokumentime etnografike ilustrojnë të drejtat e Shqipëris mbi Kosovën dhe mbi krahinat shqiptare që e rethojnë: a) hartat etnografike; b) dokumenta etnografike të ndryshme; c) shifrat

(1) Shifrat e këtyre statistikave janë riprodhuar në librin «Albanais et Slaves» të Lumo Skendos dhe në botimin «Shqipnija përpara Konferencës së Paqës».

statistikore; d) përpjestimi i popullsis shqiptare në krahasim me elementet e huaja që prej kohe kanë mundur të infiltrohem atje.

A) **Hartat etnografike.** — Të botuara nga autorë të huaj, edhe kur këta janë prej origjine sllave, ato pasqyrojnë përgjithërisht fizionomin thjesht shqiptare të Kosovës. Këto harta që kanë qënë riprodhuar në librin e autorit bullgar D. Rizoff *Les Bulgares dans leurs frontières historiques, ethnographiques et politiques* (Berlin 1917) dhe në librin *Albanais et Slaves* (Lausanne 1919) të Lumo Skëndos, munt të konsiderohen si variante të njerajetrës sepse midis tyre egzistojnë pak ndryshime.

Një nga hartat etnografike më të reja është ajo e Prof. J.J. Kettler (Flemming, Berlin 1920), e cila ka mundur të konfirmojë të drejtat t'ona në një kohë kur infiltrimi sllav në Kosovë kishte filluar të bënte efektet e veta. Harta e Kettlerit si dhe ajo e Kiepertit (Berlin 1876) meritojnë më shumë se të tjerat të merren si bazë sepse janë veprat e dy autorëvet të shquar dhe me autoritet në lëmën etnografike, dhe mbassi që të dy janë prej kombësie gjermane, duhen konsideruar gjithashtu objektivë dhe të paanëshmë. Simbas këtyre hartavet është tokë shqiptare katërkëndëshi që përmblidhet midis një vije që në Veri vete nga Novi-Pazari në Leskovac, në Lindje nga Leskovaci në Kumanovë, Shkup, Veles; në Perëndim nga Novi-Pazari në Gusi e në bregun ekstrem veri-perëndimor të liqenit të Shkodrës.

Përveç këtyre në librin e shkëncëtarit italian Roberto Almagià me titull « *Albania* » (Rome, 1930), në faqen 173 është botuar një hart'e Shqipëris që tregon zonat e banuara kompaktërisht nga Shqiptarë në vitin 1875. Simbas kësaj harte që pasqyron përfundimin e studimevet etnografike mbi Shqipërin, vija etnike shqiptare niset nga Novi-Pazari, vete në Lindje mbassi bën një të kthyer të vogël në Jugë, mandej drejtohet për në ekstremin verior afërsisht në rethet e Nishit; zbret gjer në një pikë të ndodhur në veri-lindje të Vranjës, kthehet në perëndim për të zbritur mandej drejt jugës mbassi e lë jashtë Vranjën dhe vazhdon gjithënjë drejt Jugës në drejtim të Manastirit, mbassi merr brënda Preshovën, Kumanovën, Shkupin, Tetovën, Gostivarin e Kërçovën.

Në veri-perëndim kjo vije etnike përfshin brënda Rozhain, Tu-

tinin, Istokun, Pejën, Plavën, Gusìn, Podgoricën, Hotin, Grudën dhe Ulqinin.

Por hartat etnografike më interesante janë ato që u-botuan më 1924 së bashku me librin e statistikavet të regjistrimit të popullsis jugosllave të vitit 1921: njera nga hartat tregon popullsit me gjuhë amtare shqipen e një tjatër tregon popullsit muslimane të ish-Jugosllavis. Simbas hartës linguistike të përmëndur, kufiri etnik shqiptar kalon shumë në Veri të Mitrovicës dhe shkon në drejtim Jugë-Lindje afër Vranjës, duke përfshirë brënda Mitrovicën, Vuçiternin, Prishtinën, Podujevon dhe mandej zbret në Jugë shumë në Lindje të Gjilanit që përfshihet brënda së bashku me Preshovën e Kumanovën; më në funt vija etnike rethon Shkupin dhe arrin në Jugë në afërsit e Velesit.

Harta e dytë, ajo e popullsis muslimane cakton po ato vija me ndryshimin që merr brënda edhe Novi-Pazarin dhe në të gjithë Kosovën tregon një densitet popullsije më të madhe, siç do t'a shohim më poshtë.

Në disa zona hartat në fjalë paraqësin dhe mungesa. Për shembëll elementi shqiptar gjëndet dhe në zona të ndodhura pertëj krahinavet shqiptare të Kosovës, si në Leban. Me gjithë se simbas statistikavët të vitit 1921 gjënden afro tremijë Shqiptarë në Leban, ata nuk figurojnë në hartat e lart përmëndura.

B) **Dokumenta etnografike të ndryshme.** — Hartavet etnografike të përmëndura më lart, duhet t'u shtojmë edhe një varg dokumentash e studimesh që provojnë se ku shtrihet dhe gjer ku arrin Shqipërija etnike. Këto prova i gjejmë në veprat e studiozëvet të huaj të shquar dhe me autoritet në çështje etnografike, dhe prej të cilëve disa e kanë shëtitur vëndin vetë. Midis tyre duhet përmëndur Georg von Hahn dhe vepra e tij *Albanesische Studien* (Jena 1854) e cila i përfshin të katër vilajetet (Janinë, Shkodër, Shkup dhe Manastir) brënda kufive etnike të Shqipëris. Është i rëndësishme nga pikëpamja etnografike e gjeografike dhe vepra e tij *Reise von Belgrad nach Salonik.* (Vienë 1868).

Një nga autorët që e kanë njohur dhe përshkruar mirë Shqipërin etnike është dhe shkrimtari frances Ami Boué me veprën e tij *La Turquie d'Europe* (Paris 1840, vol. II, faqe 13).

Po japim këtu poshtë disa dokumenta dhe një listë të veprave të studiozëvet të huaj të tjerë që kanë folur mbi Shqipërin etnike:

H.N. Brailsford: *Macedonien, its races and their future* (London 1906, faqe 271).

Noel Buxton: *Europe and the Turks* (London 1907, faqe 48-49).

Charles Woods: *La Turquie et ses voisins* (faqe 83).

Antonio Baldacci: *Il nuovo stato d'Albania (Rivista militare italiana*, Roma 1913, faqe 4).

Gabriel Louis-Jaray: *L'Albanie inconnue* (Paris 1913, faqe XIV, XXI, 10, 52, 56, 71, 73) dhe *Au jeune Royaume d'Albanie* (Paris 1914, faqe 80, 170, 171).

Epaminondas Mavromatis: Studim i botuar në fletoren *Akropolis* të Athinës, dhe riprodhuar në *Pettermans Mitteilungen* 1884. vol. 30.

Carl Sax: Erlauterung zu der ethnografische Karte der Europische Turkei.

Dokumentat diplomatike të botuara në librat e kaltërta engleze (Blue Books) pas vitit 1870.

Statistikat turke të vitit 1912.

Statistikat austriake, të përpiluara në kohën e okupasionit në luftën e madhe.

Statistikat e institutit kartografik të Sofies.

Hartat etnografike dhe pjesët më interesante të vepravet të lart përmëndura janë riprodhuar në veprën *Albanais et Slaves* të Lumo Skëndos (Lausanne 1919), e cila është një enciklopedi e vërtetë e gjithë çështjeve historike dhe etnografike mbi Shqipërin gjer më 1919. Në këtë vepër përmënden edhe botime të tjera mbi këto çështje. (Shih më poshtë anekset).

C) **Shifrat statistike.** — Simbas statistikavet turke dhe austriake dhe simbas shumicës së autorëvet, numëri i Shqiptarëvet që banojnë në tokat e ish-Shtetit jugosllav arrin reth 800.000 frymëvet (1). Edhe statistika jugosllave e vitit 1921 tregon një numër Shqiptarësh përmbi 700.000, por i quan muslimanë. Mbassi në ish-Jugosllavin nuk ka pasur Turq veçse në një sasi shumë të vogël, munt të themi se vetë statistika jugosllave e kishte njohur realitetin etnik shqiptar. Numëri i Turqvet në ish-Jugosllavin nuk ka kaluar

kurrë të 60.000 frymët të cilët kanë qënë të vendosur afër kufirit bullgaro-jugosllav, sidomos në Shtip, e në Kavadar.

Në sasin e muslimanëve, statistika jugosllave një pjesë të tyre e konsideron si sërbe, dhe egzazheron numërin e tyre. Sidoqoftë këta janë dhe e ndjejnë vetëhen shqiptarë. Në kohën e sundimit otoman, për shkak të mungesës së priftërinjve, Shqiptarët katolikë dhe ortodoksë thrisnin priftërinj sllavë, të cilët i kthenin katolikët në ortodoksë dhe mbassi flisnin vetëm sllavisht u mësonin Shqiptarëvet sllavishten. Mandej këta Shqiptarë të sllavizuar janë këthyer në fenë myslimane.

Numëri 441.000 banorë prej gjuhe amtare shqipen që tregohen po n'atë statistike nuk ka qënë tjatër veçse një mistifikim për të fshehur realitetin. Kriteri i përdorur për regjistrimin e vitit 1921 është ay i gjuhës amtare, kriter i cili ka një vleftë relative sepse nuk merr parasysh racën, origjinën, zakonet dhe ndjenjat e popullsis. Nga ana tjatër personat që bënin regjistrimin shënonin arbitrarisht sërbishten si gjuhë amtare; mjaftonte që një kryetar familje të dinte dy fjalë sërbisht, ay dhe gjithë familja e tij shënoheshin si sërbë.

Një shënjë që zbulon haptazi qëllimin e ish qeveris jugosllave për të shpërngulur elementin shqiptar është fakti se ndërsa statistika jugosllave e mëpasme, ajo e vitit 1931, egzazheronte numërin e Turqvet të Jugosllavis dhe e çmonte në afro 132.000 frymë, marrëveshja turko-jugosllave e vitit 1938 parashikonte shpërnguljen e 250.000 Turqve. Në vitin 1926 kur u-bë tentativa e parë për një marrëveshje turko-jugosllave po për këtë qëllim, palët parashikonin që të shpërngulnin afrò 400.000 të ashtuquajtur Turq, të cilët në realitet s'munt të ishin tjatër veçse Shqiptarë.

Një vështrim në librin mbi regjistrimin e popullsis së Jugosllavis më 1921 na tregon me një herë se distriktet shqiptare ishin banuar në shumicë dërmuese prej Shqiptarësh. Për këtë qëllim mjafton të krahasohen midis tyre të dy shtyllat e muslimanëvet (shqiptare) dhe të serbo-kroateve, emër me të cilin statistika përfshin të gjithë Sllavët e Jugosllavis: Malazes, Boshnjakë, Kroatë, Serbë, Bullgarë Maqedhonas, Shqiptarë muslimanë të sllavizuar ose gjysmë të sllavizuar dhe Shqiptarë ortodoksë të sllavizuar ose jo. Per sa u përket Shqiptarëvet të sllavizuar, duhet shënuar se po të merret parasysh

edhe numëri i tyre, numëri i përgjithshëm i Shqiptarëvet që jetonin në Jugosllavi kalon përmbi një milion frymë. Shkruan Prof. Antonio Baldacci në librin e tij *Albania* (Rome, 1929) në faqen 178: « In conclusione io computo, in seguito ai miei accertamenti che gli Albanofoni, compresi perciò i Serbi musulmani arnauti, che parlano indifferentemente in famiglia il serbo e l'albanese) superano in Jugoslavia il milione di individui. Di questi, affermo, 700.000 sono Albanesi purissimi.» Gjithë po në atë veprë të Baldaccit figuron përshkrimi i disa qyteteve të Shqipëris etnike, me karakteristikat e tyre të posaçme dhe me shifra mbi popullsin, të cilat shifra qëndrojnë ndënë realitetin.

Tash po të nxjerrim disa shifra nga statistika jugosllave e vitit 1921 do të shohim se si në shumë krahina rezulton sasija dërmuese e popullsis shqiptare me gjithë mistifikimet e kurdisura nga kompilatoret e statistikës:

	Muslimanë (Shqiptarë)	Sërbë (dhe Malazes, e Sërbë të ardhur)
ZVEÇAN	50.266	21.019
Mitrovica (komuna)	6.712	3.976
Vuçiterni	19.841	4.683
Drenica	17.864	1.588
KOSOVA	124.176	47.185
Prishtina (komuna	9.233	4.757
Gjilani	48.377	22.135
Graçanica	18.914	9.895
Labi	25.251	2.514
Nerodmilje (Ferizaj)	22.401	7.834
PRIZREN	77.304	27.816
Prizren (komuna)	10.934	4.855
Gora	12.210	6.365
Podgora	11.366	1.905
Podrima	26.250	5.383
METOHIJA (Dukagjin)	65.381	16.212
Peç (Peja), komuna	9.187	6.027
Jakovica (Jakova)	25.604	1.017
Peç (Peja), rethi	17.367	3.451

Për sa i përket Metohis (Dukagjini) numëri i banorëvet që flasin gjuhën shqipe në statistikën në fjalë rezulton më i madh se numëri i muslimanëve. Numëri i atyre që flasin gjuhën shqipe është shënuar me shifrën 70.920. Diferenca prej më shumë se pesëmijë frymë që egziston midis kësaj shifre dhe asaj së muslimanëve përfaqëson numërin e Shqiptarëve katolikë. Në realitet numëri i Shqiptarëve katolikë n'atë krahinë është më i madh.

Në shifrat që radhiten më sipër, numëri i sllavëvet përbëhet prej elementesh të ndryshëm si sërbë, kroatë, malazes, gjë që ia shton rëndesin numërit të shqiptarëvet. Në disa krahina të tjera si në Shkup, Kumanovë, Tetovë,etj... në shtyllën e sërbo-kroatëvet përfshihet dhe elementi maqedhonas, i cili është sllav prej gjuhe, prej fés dhe prej traditavet, kurse etnikisht nuk është sllav por më shumë prej race iliro-trako-maqedhone e kryqëzuar me sllavë në disa krahina ndërsa ka mbetur më e kulluar në disa të tjera. Nga ana tjatër një pjes'e elementit maqedhonas etnikisht është arumune, dhe ruan edhe sot gjuhën dhe traditat rumune. Nga pikëpamja politike elementi maqedhonas është i përçarë, simbas ndjenjavet që ushqen në tri grupe të mëdha: filosërbë, filobullgarë, filorumunë. Kjo gjëndje e elementit maqedhonas e forcon edhe më tepër shumicën e grupit etnik shqiptar, i cili nga çdo pikëpamje paraqitet më kompakt:

	Muslimanë (Shqiptarë)	Sërbë (Sllavë maqedhonas dhe Sërbë të ardhur)
Shkup (komuna)	15.713	22.310
Shkupi (rethi)	24.299	29.790
Kaçanik	10.487	233
TETOVA	70.213	53.508
Tetova (komuna)	8.196	7.090
Galiçnik	5.180	8.738
Gornji Polog (rethi i Tetovës)	19.335	9.050
Donji Polog (Gostivari dhe rethi)	33.031	14.470
Kumanovë (komuna)	4.071	9.204
Zegligovo (rethi i Kumanovës	11.757	27.943

Presheva	17.673	19.732
OHRID	24.041	48.318
Ohri (Komuna)	4.317	4.766
Gorni Debar	9.011	8.571
Ohri (rethi)	225	19.330
Struga	10.480	15.651

Për të kuptuar mirë shifrat e reshtuara këtu sipër dhe për t'i interpretuar si duhet do të jepen më poshtë disa shpjegime në kaptinën ku do të shqyrtohet proporcioni i popullsis shqiptare.

Sa do që disa nga shifrat e reshtuara më sipër janë të favorëshme për elementin shqiptar, duhet patur parasysh se ato qëndrojnë gjithënjë larg realitetit, sepse janë përpiluar nga një autoritet që ka pasur kurdoherë për qëllim ta shdukë ose ta shpërngulë elementin shqiptar nga ato vise. Në leximin dhe interpretimin e statistikavet jugosllave duhet patur gjithënjë në sy se mistifikimi ka qënë sistemi i zakonshëm për të fshehur numërin e elementit shqiptar; këto mistifikime shtetet ballkanikë i kanë përdorur në shkallë të gjerë njeri kundër tjetrit, por mjerisht i kanë përdorur sidomos kundër elementit t'onë.

Statistika më e ré mbi popullsit muslimanë të Jugosllavis jugore është ajo e komunitetit musliman (Ulema Mexhlisi) të Shkupit, botuar në Sarajevo në kalendarin e vitit 1941 dhe që tregon në një pasqyrë të përgjithëshme (faqe 24) sasin dhe përqindjen e popullsis muslimane të çdo distrikti për vitin 1939:

	Muslimanë	Përqindja mbi popullsin e përgjith.
Perane (Rozhai)	14.862 (Shqiptarë e Sllavë)	45%
Bitolja (Manastir)	13.252 (Shqiptarë)	16%
Velesi (Koprulu)	12.939 (Shqiptar'e Turq)	27%
Vuçiterni	25.644 (Shqiptarë)	90%
Gjilani	63.783 (Shqiptarë)	74%
Gostivari	38.786 (Shqiptarë)	70%
Dibra	12.995 (Shqiptarë)	60%
Jakova	34.885 (Shqiptarë)	87%
Kaçaniku	13.124 (Shqiptarë)	98%

Kërçovë (Kiçevo)	20.967 (Shqiptarë)	52%
Mitrovica	14.173 (Shqiptarë)	45%
Kumanova	21.044 (Shqiptarë)	16%
Novi-Pazari	38.705 (Shqiptarë e Sllavë)	66%
Rahova (Orahovac)	35.150 (Shqiptarë)	90%
Ohri	5.267 (Shqiptarë)	15%
Peja (Peç)	46.827 (Shqiptarë)	66%
Plava	8.753 (Shqiptarë)	32%
Podgorica	5.412 (Shqiptarë e Sllavë)	13%
Podujeva	30.184 (Shqiptarë)	95%
Presheva	24.048 (Shqiptarë)	60%
Prizreni	73.430 (Shqiptarë)	90%
Prilepi	15.569 (Shqiptarë)	16%
Prishtina	37.226 (Shqiptarë)	70%
Resnja (Resan)	5.645 (Shqiptarë)	28%
Senica	18.893 (Shqiptarë e Sllavë)	65%
Shkupi (Skoplje)	57.791 (Shqiptarë)	43%
Drenica (Serbica)	25.054 (Shqiptarë)	100%
Tivari (Stari Bar)	8.742 (Shqiptarë e Sllavë)	49%
Struga	15.925 (Shqiptarë)	51%
Tetova	57.310 (Shqiptarë)	88%
Ulqini	7.497 (Shqiptarë)	—
Ferizaj (Uroshevac)	29.240 (Shqiptarë)	80%

Shpjegimet mbi këto numëra do të jepen më poshtë në kaptinën që vijon, ku do të shqyrtohet përqindja e popullsis shqiptare mbi popullsin e përgjithëshme.

D) **Proporcioni i popullsis shqiptare.** — Kemi thënë më lart se në krahinat shqiptare të aneksuara nga Jugosllavija, sasija e Sllavëve të infiltruar para vitit 1912 përfaqësonte 5% të popullsis së përgjithëshme. Me gjithë se pas vitit 1912 infiltrimi sllav në Kosovë shkoi duke u-shtuar dhe me gjithë se më von qeverija jugosllave përdori çdo mjet për këtë qëllim, elementi shqiptar mundi të ruajë një proporcion të fortë. Kështu munt të konstatohet për shëmbëll se simbas statistikes jugosllave të vitit 1921, në Vuçitern, Prishtinë, Graçanicë, Ne-rodmilje, Prizren, elementi musliman (shqiptar) paraqitet në

një shumicë dërmuese, ndërsa në Drenicë, Lab, Podgorë, Podrimë, Has, Kaçanik, elementi shqiptar ka një shumicë aq të madhe për kundrejt Sllavëve sa që këta as që meritojnë të përmenden. Për këtë qëllim këndonjësi munt të konsultojë shifrat që kemi paraqitur më sipër. Shifrat më të favorëshme për elementit t'one janë sidomos në Has (6.377 Shqiptarë kundër 2 Sërbë), dhe në Kaçanik (10.487 Shqiptarë kundër 233 Sërbë).

Realiteti i pakontestueshëm që flet në favor të Shqiptarëve të Kosovës ka qënë konkretizuar edhe më mirë në hartat anekse në librin e statistikës jugosllave të vitit 1921. Harta e muslimanëve të Kosovës tregon se shumica e zonave janë të banuara me 75 gjer më 100% muslimanë (Shqiptarë). Këto zona ndodhen në veri dhe në jugë të Mistrovicës. Atë përqindje kanë dhe krahinat e Podujevos, Vuçiternit, Laushës (Drenicë), zonat e ndodhura midis Gjilanit e Vraniës, sidhe Presheva, Kumanova, Kaçaniku, Ferizaj (Uroshevac), Rahova (Orahovac), Suha Reka, Prizreni, Tetova, Gostivari e Kërçova (Kiçevo). Krahinat e tjera që përfshihen brënda kufirit etnik shqiptar tregojnë një përqindje Shqiptarësh prej 50 gjer më 75%.

Edhe harta linguistike e gjuhës shqipe, me gjithë se e fsheh numërin e vërtetë të Shqiptarëve e konfirmon përqindjen e tyre të madhe 95-100% në veri të Mitrovicës, në Podujevo, në zonen midis Vuçiternit e Laushës (Drenicë), në zonën e ndodhur në lindje të Gjilanit, në Kaçanik, në Rahovë (Orahovac) dhe në perëndim të Prizrenit; harta në fjalë tregon 75-95% Shqiptarë në distriktet e Kumanovës, Preshevës, Ferizait (Uroshevac), Prishtinës, Vuçiternit, Suha Rekës, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës.

Munt të heqë vërejtjen e këndonjësit fakti se ne këto dy harta Drejtorija e statistikës së Belgradit nuk ka përdorur një sistem të njejtë në paraqitjen e përqindjeve: në harten e parë përdoret shifra 75-100%, kurse në hartën e dytë përdoren dy shifra të ndryshme: 75-95% dhe 95-100%. Me këtë sistem në hartën e dytë, do me thënë në atë të gjuhës shqipe, rezultojnë më pak zona të shënuara me ngjyrë të thellë se sa në hartën e popullsis muslimane; gjë që ndodh edhe kur tregohen zona më përqindje të barabartë. Për shëmbëll në hartën e muslimanëve zonat e Kumanovës dhe të Preshevës janë shënuar me ngjyrë të thellë dhe uniforme simbas përqindjes së caktuar në legjendë: 75-100%. kurse në hartën e gjuhës shqipe mbassi është përdorur një sistem i

ndryshëm, po ato zona (Kumanova dhe Presheva) që kanë një popullsi shqiptare 75-95% tregohen me një ngjyrë më të shplarë, në mënyrë që densiteti i popullsis shqiptare paraqitet më i dobët përpara këndonjësit që hedh vështrimin e parë mbi atë hartë.

Për të plotësuar më mirë këto përshkrime, shtojmë edhe një dëshmi po prej burimit zyrtar jugosllav: Besimtari i reformës agrare jugosllave G. Krstiq, në librin e tij *Kolonizimi i Sërbisë jugore* (Sarajevo 1928) çqetesohet shumë për densitetin dhe kompaktësin e elementit shqiptar të Kosovës, dhe kjo e shtyn të jetë aqë shovin dhe antishqiptar në zbatimin e reformës agrare jugosllave. Ky autor tregon 72% Shqiptarë në Kosovë kundër vetëm 24% Sllavë (faqe 78) dhe në Kaçanik më pak se 3% Sllavë kundër një shumice dërmuëse prej 97% Shqiptarë dhe as që e sheh të nevojëshme t'i quajë Shqiptarët: muslimanë, turq a sllave siç përpiqet të bëjë statistika zyrtare jugosllave, sepse gjëndja demografike e Kosovës nuk munt të fshihet.

Për sa shikon qytetin e Shkupit, me gjithë se në kohën e regjimit jugosllav, elementi shqiptar nuk ka pasur shumicën absolute të popullsis, siç ngjet në disa qytete e distrikte shqiptare të tjera, duhet pasur parasysh fakti se ne atë qytet dhe në rethet e tij kemi të bëjmë me një element që nuk egziston në krahinat e tjera; ky element përbëhet prej Maqedhonasvet. Këta, së bashku me Sërbët e infiltruar që prej vitit 1912, përbënin popullsin sllave të qytetit, e cila popullsi po të ndahesh më dysh, në Sërbë dhe në Maqedhonas, e humbiste vlerën e saj si shumicë, në menyrë që popullsia shqiptare kishte në qytet shumicën relative përkundrejt të dy elementevet sllave veç e veç. Nga ana tjatër duhet theksuar se popullsija sërbe e Shkupit nuk ka qënë vëndëse sepse përbëhesh prej nëpunësa, oficera, punëtore etj. të ardhur nga të gjitha anët e Jugosllavis së bashku me familjet e tyre. Për këtë aresye në numërin e përgjithëshëm të *popullsis vëndëse*, elementi shqiptar ka pasur në Shkup kurdoherë shumicën absolute.

Simbas statistikavet jugosllave të vitit 1921 (faqe 16), rethi Shkupit kishte një popullsi të përgjithëshme prej më shumë se 50.000 frymë, nga të cilet 24.299 figuronin si muslimanë (Shqiptarë) dhe vetëm 18.032 frymë, statistika në fjalë i njihte si Shqiptarofonë. Si mbas statistikës në fjale numëri i Sllavëve arrinte në 29.790, numër i cili është i egzazheruar Tash po të merret parasysh se në numërin e Sllavëve përfshihen të paken dy elemente të ndryshmë: Sërbë dhe Maqedhonas

nga Shkupi: me mijëra familje shkuan në vend-lindjen e tyre, në Sërbi duke lënë një vënd të zbrazët që s'ka se si mbushet dhe që e bën sot gjëndjen etnike të jetë krejt në favor të Shqiptarëve, të cilët sot në qytet arrijnë afrò 30.000 frymë kundrejt një pakicë maqedhonase e sllavësh të tjerë që mezi arrijnë numërin 15.000 frymë. Proporcioni i *popullsis vëndëse* sè qytetit sot është afrò ay që jepet prej autorit frances të lart përmëndur Gabriel Louis-Jaray. Në sasin e përgjithëshme të *popullsis vëndëse*, Shqiptarët kanë pasur kurdoherë shumicën absolute. Këtë gjë e konfirmon autori bullgar Jordan Ivanov dhe Hahn-i, i cili jep këto shifra: 13.000 muslimanë, 7.000 ortodoksë dhe 800 israelitë. Muslimanët janë pothuaj të gjithë Shqiptarë, kurse ortodoksët janë të ndarë në Bullgaro-maqedhonas, Serbë dhe Arumunë (Reise von Belgrad nach Salonik, Vjenë 1868).

Shkupi është një qëndrë shqiptare jo vetëm nga pikëpamja etnike por edhe nga pikëpamja gjeografike, ekonomike dhe e komunikasioneve, mbassi ndodhet në mes të dy krahinave me rëndësi të Shqipëris etnike: Kosoves dhe Tetoves. Per këtë arësye Shqiptaret kanë lojtur kurdohere nje rol të dores se pare në zhvillimin ekonomik të qytetit, dhe kanë pasur kurdoherë shumicën e *popullsis vëndëse*.

Në statistikën e vitit 1921, për krahinat e Kumanovës (Zegligovo) dhe të Preshevës, numëri i sllavëve rezulton të jetë tepër i madh në krahasim me atë të Shqiptarëve për shkak se krahinat në fjalë shtrihen tepër në lindje dhe në distriktin e tyre përmbledhin edhe zona sllave, kurse Shqiptarët ndodhen në zonën perëndimore në shumice kompakte.

Sidoqoftë statistikat sërbe duhen marrë me rezervë, sepse numërin e Shqiptarëve e çvleftesojnë dhe numërin e Sërbëve e ritin më shumë se ç'është. Nga ana tjatër në numërin e Sërbëve futin dhe elemente të tjera: Shqiptarë ortodokse, Shqiptarë muslimanë të sllavizuar ose gjysmë të sllavizuar, Shqiptarë katolikë, Bullgaro-maqedhonas, popullsira sllave jo vëndëse si Sërbët e ardhur.

Nga ana tjatër këto statistika nuk i shënojnë kurrë katundet një nga një me popullsit e tyre përkatëse, sepse një sistem i tillë do ta nxirrte më shumë në dukje elementin shqiptar. Uniteti administratif më i vogël është komuna, në të cilin është më lehtë të përzihen dhe të ngatërronen përqindjet dhe numëri i popullsive të ndryshme. Por edhe për komunet nuk jepet veç e veç sasija e popullsive prej race të ndry-

shme, por shuma e përgjithëshme e të gjithë banorëve pa dallin race dhe feje. Me këtë mënyrë kontrolli i shifrave në vënd është pothuaj i pamundur.

Në statistikat në fjalë në numërin e popullsis së qyteteve nga ndonje herë shënohen dhe banorët e katundeve sllave që ndodhen afër qytetit. Ky sistem është përdorur për shëmbëll për qytetin e Shkupit.

Për sa i përket përqindjes së popullsis shqiptare simbas statistikave të komunitetit musliman që janë riprodhuar disa faqe më lart, në disa krahina ajo i afrohet shifrës 100%: Drenicë (Sërbicë), Kaçanik, Podujevo, Prizren, Rahovë, Vuçitern, Tetovë. Në shumë krahina të tjera proporcioni qëndron përmbi 50% kurse në disa të tjera mbetet ndënë 50%. Përqindjet e vogëla ndodhen përgjithërisht në ato krahina që gjënden në periferin e Shqipëris etnike, sepse atje kufiri administrativ i krahinës shkon edhe më tutje për të përfshirë brënda zona të banuara nga sllavë, përkundrejt të cilëve popullsija shqiptare, me gjithë që kompakte, mbetet në pakicë. Qeverija jugosllave i zgjeronte kështu distriktet për së tepërmi me qëllim që përqindja e shqiptarëve ndër statistikat të rezultonte më e vogël dhe elementi sllav të favorizohej si nga pikëpamja etnike ashtu dhe nga pikëpamja elektorale. Kështu ndodh për shëmbëll për krahinat e Kumanovës dhe të Preshevës, të cilat shtrihen për së tepërmi drejt lindjes gjer në Kratove dhe Kriva Palanka duke përfshirë brënda shumë sllavë, kurse zonat thjesht shqiptare të këtyre dy krahinave ndodhen në perëndin të lumit Pçinja dhe kanë një popullsi kompakte shqiptare me një proporcion afrò 100%, e cila është vendosur në faqen lindore të malit Karadag (Crnagora) në një varg prej afrò shtatedhjetë katundesh.

Me sistemin administratif në fjalë përqindja e popullsis muslimane në distriktin e Kumanovës zbret kështu në 16% dhe në distriktin e Preshevës në 60%. Kështu ndodh edhe në krahinat e tjera periferike: në Veles, Mitrovicë, Plavë, Podgorice, Tivar.

Nga ana tjatër në krahina të tjera si ajo e Shkupit, ku statistika e komunitetit musliman shënon një përqindje prej 43%, duhet marrë parasysh se në kohën e Jugosllavis popullsija sllave përbëhesh në Shkup e në rethet prej një sasije të madhe Sërbësh të ardhur nga të gjitha anët e Jugosllavis (nëpunës, oficera, punëtorë, katundarë, kolonë etj. dhe familjet e tyre). Po të zbritet numri i këtyre (afrò 40.000)

nga popullsija e përgjithëshme, proporcioni i popullsis muslimane arrin 65%.

Statistikat e komunitetit musliman, të riprodhuara më lart, janë kompiluar në vitin 1939, d.m.th. të paktën pas njëzet vjet sundimi jugosllav, kohë në të cilën, qeverija e Belgradit me programin e kolonizimit që u-zbatua në shkallë të gjerë, arrijti ta pakësojë përqindjen e popullsis shqiptare. Siç do të shihet edhe më poshtë, me rastin e shqyrtimit të veprës së çkombëtarizimit dhe të kolonizimit, reforma agrare dhe kolonizimi jugosllav që kishin dy efekte kryesore, vendosja e kolonëvet sllavë dhe shpërngulja e detyrueme e elementit shqiptar, nuk arritin me gjithë këtë t'a cenojnë proporcionin e popullsis shqiptare, e cila edhe sot, me gjithë vuajtjet që pësoi, e sundon elementin sllav në numer. Duhet pasur parasysh nga ana tjatër se elementi shqiptar i Kosovës është mjaft prolifik, gjë që i ka lejuar të ruajë të pakten densitetin që kishte para luftës ballkanike; për këtë arësye as emigrimi i detyruar as persekutimet dhe masakrat nuk e kanë cénuar sasin e tij të përgjithëshme.

Statistikat e komunitetit musliman duhen marë dhe ato me rezërvë sepse kanë mungesa për shkak se shërbimi i gjëndjes-civile i komuniteteve fetare muslimane përgjithërisht nuk ka funksionuar mirë dhe për shkak se shpesh herë familjet muslimane nuk i regjistrojnë të gjithë fëmijët e tyre.

Për sa i përket zonavet të Manastirit, Përlepit, Resnjës dhe Ohris, të cilat historikisht, gjeografikisht dhe etnikisht kanë qënë kurdoherë shqiptare, përqindja e popullsis shqiptare atje paraqitet më e vogël se në krahinat e tjera të Kosovës. Manastiri ka lojtur një rol të rëndesishëm në historin e Shqipëris dhe ndodhet brënda kufivet natyrale të Shqipëris, porse proporcioni i vogël i popullsis shqiptare t'atjeshme munt të bëhet shkak që një ditë kjo popullsi të shkëmbehet me elementin sllav të krahinës së Dibres, Tetovës dhe Strugës, i cili ka prirje të largohet.

Vetëm në sektorin e Manastirit, shkëmbimi i popullsis shqiptare munt të ketë një realizin pratik, kurse në asnjë nga krahinat e tjera të Shqipëris etnike shkëmbimi nuk munt të zbatohet sepse elementi shqiptar është kompakt dhe në proporcion të madh.

Përfundimisht në krahinet shqiptare të përshkruara më sipër dhe të aneksuara nga Jugosllavijs banon një popullsi shqiptare prej afrò në-ndëqindimijë frymësh, prej të cilëve një sasi fare e vogël përbehet prej Shqiptarë të sllavizuar ose gjysmë të sllavizuar.

Sasija e popullsis shqiptare mbi popullsin e përgjithëshme të a-tyre viseve arrin një proporcion prej afrò 80%, kurse pjesa tjatër prej 20% përbëhet prej elemente etnike të ndryshme si Sërbë e Malazes, banuës të vjeter a kolonë, në anën e Malit të Zi, prej Serbë të vjetër e Serbë kolonë në fushën e Kosovës e në krahinat fqinje, prej Sërbë, Maqedhonas sllavë dhe Arumune në anën e Maqedhonis.

Popullsija shqiptare pra nuk ka vetëm shumicën në sasi por është dhe një element etnik kompakt dhe i bashkuar si nga pikëpamja racia-le ashtu dhe nga pikëpamja politike dhe i sundon më mirë kështu elementet e pakicës të përçara në raca e kombësira të ndryshme, dhe të përhapura si ishuj të vegjël në « detin shqiptar ».

PJESA E III.

VEPRA E ÇKOMBËTARIZIMIT E KRYER KUNDËR ELEMENTIT SHQIPTAR TË KOSOVËS

Me copëtimin që pësoi Shqipëria pas luftës ballkanike në traktatin e Bukureshtit, qendrat dhe pjesat më të begatëshme të provincavet a vilajetevet shqiptare të perandoris otomane mbetën në duart e shtetevet ballkanikë. Aleatët ballkanikë, kur filluan luftën kundër Turqis më 1912 kishin caktuar si një nga qëllimet e tyre edhe çlirimin e « vëllezërvet shqiptarë », kurse në realitet i konsideruan Shqiptarët dhe vëndin e tyre si një pjesë të njëjtë me perandorin otomane. Kështu Shqipëria humbi Janinën, Manastirin dhe Shkupin me juridiksionet e tyre, që pësuan gjer djé të gjitha të zezat e politikës demografike të zbatuar nga Sërbët e Grekët kundër elementit shqiptar.

Kufit e 1913-s i linin Shqipëris si qëndër me rëndësi vetëm Shkodrën, që mbetej e mutiluar dhe ajo nga një pjes'e madhe e juridiksionit të saj, dhe që me mbeturinat e tre vilajetevet të tjera shqiptare formoi teritorin e Shtetit të ri shqiptar.

Q'atehere fillojnë vuajtjet më të këqia për popullsit shqiptare iredente. Vepra e çkombëtarëzimit, e filluar nga Turqit e Rinj, që përdorën çdo mjet për të shtypur rilindjen e kombit shqiptar, u-vazhdua prej Sërbëvet pa pushim, me metodë dhe energji. Gjer më 1921, popullsit shqiptare të vëndevet të shkelura u bënë viktima e ushtarakëvet sërbë dhe të « çetnikëvet » o çetavet të organizuara me qëllim që të çfarosin elementin shqiptar. Kështu u-masakruan me mijëra shqiptarë, u-dogjën dhe u-plaçkitën me qindra katunde, prona të panumërta u-konfiskuan. Midis së tjeravet po përmëndim botimin « Les Droits de l'Albanie à ses frontières naturelles » të Komitetit të Shqiptarëvet iredente (Vlorë 1921) ku tregohet bilanci i tmerrshëm i atrocitetevet sërbe në Rugovë e në të tjera vënde të Kosovës: 12.371

të vrarë, 22.110 të burgosur, 6.050 banesa të prishura, 10.526 të plaçkitura (1).

Mandej u-përdorën si mjete çkombëtarëzimi emigrimi i detyruem dhe masakrat. Të gjitha përdhunimet e atrocitetet nuk e arritën qellimin e dëshëruar prej sunduesvet tiranikë, sepse raca shqiptare, që kish mundur të konservohej midis vuajtjesh shekullore, ka ditur t'u bëjë ballë me një rezistencë të fortë dhe me një shpirt therorie të jashtëzakonshme keq-përdorimeve të pashoqa të kryera nga Sërbët.

Gjëndja e Shqiptarëvet iredente pas luftës botnore nuk u përmirësua aspak, me gjithë detyrimet që kishte marrë Jugosllavia përkundrejt pakicavet.

Kështu popullsit shqiptare të Kosovës u-detyruan të durojnë metodat e sërbizimit që ishin të ndryshme: mosnjohja e grupit etnik shqiptar, masakra me shumicë, emigrimi i detyruar, moslejimi i mësimit të gjuhës shqipe nëpër shkolla, refuzimi i së drejtës së shoqërimit, obstruksionizmi dhe mistifikimi elektoral, dhe më në fund grabitja e tokavet me mjete paqësore, si kolonizimi i tokavet të Shqiptarëvet me Sërbë dhe e ashtu quajtura reforma agrare jugosllave.

Para se të shqyrtojmë këto mjete grabitjeje, është e nevojëshme të theksojmë se data 1912 përbën një pikënisje për sërbizimin e Kosovës. Në fakt kemi parë më sipër se, ndërsa gjer më atë datë elementi serbomalazes i infiltruar aty përbënte vetëm 5% të popullsis së përgjithëshme, nga 1912 e tëhu ky infiltrim shkoi duke marrë proporsione të mëdha, për shkak të metodavet të sërbizimit të lartpërmëndura që më von u-ngritën nga Qeveria e Belgradit në sistem politik, me qëllim që të realizohej fuzionimi i dëshëruar i elementevet etnike të ndryshmë që përbënin atë mozaik popujsh që quhej Jugosllavi. Sidomos elementi etnik shqiptar, kompakt dhe i shumë, ishte një kokëçarje për Jugosllavin. Zbatimi i mjetevet grabitëse të lartpërmëndura bëhet më rigoroz pas vitit 1927, me një herë pas paktit të miqësis italo-shqip-

---

(1) Shif gjithashtu:

a) Enquête dans les Balkans. Rapport de la Commission d'enquête de la Dotation Carnégie pour la Paix internazionale. Paris 1914.

b) Albanians Golgotha. Anklageakten gegen die Vernichter des Albanervolkes. Gesamelt und herausgegeben von Leo Freundlich Wien 1913.

c) Edith Durham: « The Struggle of Scutari ».

d) Edith Durham: « Venti anni di groviglio balcanico ».

tar. Po në atë vitin 1927 Shtabi madhor jugosllav fillon të vërë në zbatim një plan kolonizimi me qëllime ushtarake. Shtatmadhoria në fjalë e shihte të rezikshëm elementin shqiptar të ndodhur në zonat e kufirit dhe që shtrihej thellë në teritorin jugosllav. Prandaj vendosi të kolonizonte një ryp toke gjatë kufirit shqiptaro-jugosllav me elemente sllave.

Mjetet e përdorura nga Sërbët për të grabitur tokat e Shqiptarëvet me qëllim që t'i detyronin këta të linin vatrat e tyre ishin plani i kolonizimit dhe reforma agrare.

Për të arritur në kolonizimin e tokavet të Kosovarëvet, qeveria jugosllave kishte nxjerrë ligje të posaçme të cilat i konsideronin tokat private të një ose më shumë krahinave si toka shtetnore dhe titujt e pronësis ose *tapit* e tyre quheshin të pavlefshme. Gjithashtu konsiderohesh si e pavlefshme dhe e drejta e pronësis që rezultonte nga posedimi i gjatë që Shqiptarët kishin mbi tokat e tyre, e drejtë që për ligjët e perandoris otomane vëlente zakonisht si një titull pronësie ose *tapi*.

Kështu pra, zotnuesat e tokavet zvisheshin automatikisht nga e drejta e pronësis. Por këto masa zbatoheshin vetëm kundër Shqiptarëvet, sepse pronarvet sërbë e malazes, autoritetet sërbë u lëshonin dokumenta pronësie të reja, ligjisht të vlefëshme, ndërsa në bazë të urdhëravet kategorike të Qeveris së Belgradit autoritetet gjyqsore jugosllave nuk u lëshonin Shqiptarëvet tituj pronësie të tillë.

Ato toka të ashtu quajtura shtetnore mateshin dhe ndaheshin në parcela që u dorëzoheshin mandej, mbas një procedure të shpejtë, kolonistëvet sërbë e malazes.

Për sa shikon reformën agrare, qëllimi i paracaktuar prej saj ishte identik me atë të kolonizimit, duke pasur si ndryshim midis tyre vetëm metodën e zbatimit.

Me anën e Reformës agrare çpronësoheshin përgjithërisht pronat e quajtura çifliqe, dhe që mandej u ndaheshin bujqvet që s'kishin toka. Reforma agrare vepëronte nënë maskën e një qëllimi shoqëror të mirë, por në realitet çifliqet e çpronësuara u ndaheshin vetëm Sërbëvet, Malazesvet, dhe Maqedhonasvet.

Përveç kësaj çpronesoheshin vetëm çifliqe që ishin pron'e Shqiptarëvet dhe që në Kosovë nuk kanë qënë kurrë çifliqe të mëdha.

Çpronësimi i filluar më parë kundrejt çifliqevet arriti më von të

goditë edhe pronat më të vogëla. Numëri i pronavet shqiptare të çpronësuara kështu nga reforma agrare jugosllave arrin në njeqind mijë.

Këto të dy mjete grabitjeje shoqëroheshin dhe nga një sëri, veksasionesh të çdo lloji, si masa administrative arbitrare, përhapje lajmesh alarmante mbi emigrimin e detyruar, kërcënime nga ana e autoritetevet lokale dhe bilé persekutime.

Me gjithë këtë, përfundimi i gjithë kësaj vepre nuk ishte kurdoherë emigrimi i Shqiptarëvet. Mbassi ishte praktikisht e pamundur shpërngulja dhe emigrimi i një sasije të madhe prej qindramijë frymësh, u-krijua kështu në Kosovë një gjëndje e ré bashkëjetese shoqërore e njohur vetëm në kohën medievale: u-themelua me fjalë të tjera një raport i ri feudal midis Sllavësh çfrytëzuësa dhe Shqiptarësh të çfrytëzuar. Dhe me të vërtet në më të shumën e rastevet, bujku shqiptar vazhdonte t'a punonte tokën e vetë jo si pronar, siç ishte më parë, por si vasal i pronarit të ri sllav, zotnuës i titujvet të pronësis që i kishin lëshuar autoritetet jugosllave. Ky pronar i ri ishte shpesh herë një shtetas sërb ose malazes që as dinte dhe as mund t'a punonte tokën që i kishte falur qeveria jugosllave; ahere, mbi kërkimin e tij, ish-pronari shqiptar vazhdonte t'a punonte tokën duke ndarë me 'të prodhimet gjysmë për gjysmë.

Duhet theksuar së këta zotnuësa të rinj të tokavet të Shqiptarëvet, me t'u-krijuar kjo lidhje midis patronit dhe servit, e linin fushën dhe ktheheshin në punet e tyre gjetiu.

Porse nga ana tjatër, të tjere patronë të rinj të tokavet të Shqiparëvet, dhe që ishin përgjithësisht kriminale, komitaxhinj dhe çetnikë plot me merita të veçanta përkundrejt Qeveris së Belgradit, sepse kishin qënë zbatuësit e zellëshëm të programit të çfarosjes me çdo mjet të grupit etnik fatzez shqiptar të Jugosllavis, vendoseshin në tokat e grabitura me menyrat e ditura, dhe të shtyrë e të përkrahur gjithënjë nga Qeveria dhe nga shtabi madhor jugosllav kishin arritur të vendoseshin edhe në kopshtrat e atyre Kosovarëvet të mbetur në vënd me qëllim që t'ua bënin këtyre jetesën të pamundur, dhe të padurueshme.

Vetë Sërbët e kanë zbuluar qëllimin e vërtetë të planit të kolonizimit dhe të reformës agrare. Me të vërtetë fiduçiari i Reformës Agrare G. Krstiq ka pas botuar në Sarajevo, më 1928, një libër me ti-

tullin *Kolonizimi i Sërbisë Jugore*, të cilit i është aneksuar dhe një hartë me planin e kolonizimit të Kosovës.

Autori në fjalë thotë se gjer më 1927 reforma agrare nuk është zbatuar kundër elementit shqiptar me energjin e duhur dhe mandej tregon numërin e kolonistëvet sërbë e malazes të infiltruar në Kosovë gjer më 1927. Shqyrton gjithashtu dhe menyrat e ndryshme me të cilat mund të përmirësohesh zbatimi i reformës agrare, e cila, siç e kemi parë, ka pasur për qëllim largimin e elementit shqiptar nga Kosova. G. Krstiq-i është i pamëshirëshëm kundër elementit shqiptar, dhe mbassi propozon që asnjë lehtesi nuk duhet t'i tregohet këtij elementi, qërton ata deputetë të cilët, për arësye politike dhe elektorale, i kanë favorizuar nga ndonjë herë Shqiptarët.

Do t'a shqyrtojmë më hollësisht veprën e këtij zyrtari sërb, në kapitullin e fundit të këtij studimi; nga kjo veprë rezullton vetëm një pjes'e vogël e gjëndjes së mjeruëshme që e kish goditur Kosovën shqiptare; me gjithë këtë vëlen të shikohet sepse nxjerr në dritë qëllimet e fshehta të politikës jugosllave.

Në zbatimin e planit të kolonizimit dhe të reformës agrare, politika jugosllave e inspiruar dhe nga Shtabi madhor, ka pasur qëllime të shumëllojta, që mund të përmblidhen si më poshtë:

a) Vendosja gjatë kufirit me Shqipërin të një sasie Sërbësh e Malazesësh, me qëllim që të zbatohesh plani i shtabit madhor jugosllav.

b) Pakësimi dhe mundësisht asgjësimi i densitetit dhe kompaktësis së popullsis shqiptare, duke infiltruar kudo elemente sllave, pa marrë parasysh arësye ushtarake ose strategjike.

c) Grabitja e tokavet më pjellore me qëllim spekulimi.

Përfundimisht mund të thuhet se politika sërbe në Kosovë ka pasur si rezultat nga një anë krijimin e një sistemi shoqëror tipi feudal me të gjitha të këqijat dhe vuajtjet që do të ridhnin për Kosovarët, dhe nga ana tjatër emigrimin e detyruem të afrò 130.000 Shqiptarëvet, prej të cilevet pjesa më e madhe shkuan në Turqi, ndërsa një pakicë prej disa mijëra frymësh erdhi të gjejë strehë në Shqipëri, ku Shteti mundi t'i instalojë duke bërë mjaft sakrifica.

Prirja e politikës jugosllave për të dbuar me çdo mënyre elementin shqiptar pati një shprehje konkrete në akordin turko-jugosllav të vitit 1938, në baze të të cilit Turqia pranonte të instalonte në tokën e

vetë 250.000 të ashtu-quajtur Turq të Jugosllavis. Zbatimi i këtij akordi ishte siguruar me financimin e të dy palëvet dhe me një procedurë të paracaktuar (1). Akordi në fjalë në realitét nuk krijonte një gjë të ré; përkundrazi konsakronte formalisht çka po pregatitesh në dëm të Kosovarëvet që prej vitit 1912 do më thënë dbimi i tyre nga Kosova. Qeverit turke dhe jugosllave e kishin filluar këtë punë me kohë dhe egzistonte një projekt për shpërnguljen e 3-400.000 Shqiptarëvet nga Kosova, që në vitin 1926. Kjo çështje është përmëndur atëhere dhe në shtypin turk, në kryeartikujt e fletorevet *Haqimijeti Milije* dhe *Milijet* me datë 17 prill 1926.

Dy interesa bashkoheshin për realizimin e akordit turko-jugosllav: nevoja e Turqis që të popullonte stepet e Anadollit me bujq të mire siç janë Shqiptarët e Kosovës, dhe interesi jugosllav që t'a largonte me çdo mënyre elementin shqiptar. Kemi parë se për të

---

(1) Fletorja turke «Tan» nr. 1150, datë 12-7-1938, botonte një komunikatë zyrtare simbas së cilës marreveshja mbi emigrantet që do të shkonin nga Jugosllavia në Turqi ishte përfunduar. Punimet përkatëse ishin kryer prej një Komisioni turko-jugosllav që ishte mbledhur ditët e mëparëshme në Stamboll.

Të nesërmen po ajo fletore botonte një artikull me këtë titull: «Nga Jugosllavia do të vinë 250.000 emigrantë. Transportimi i tyre do të fillojë pas gjashtë muajsh. Delegasioni jugosllav u-kthye dje». Po japim këtu poshtë përkthimin e artikullit në fjalë:

«Bisedimet që vazhdonin qysh prej një muaji midis Qeveris s'onë dhe Jugosllavis për marrjen në atdhè të bashkëkombasvet t'onë të ndodhur në Jugosllavi u-përfunduan në një mënyrë të kënaqëshme për të dy Qeverit dhe delegatët jugosllavë Milan A. Ristiç dhe Voislof dje mbrëmë u-kthyen me ekspres në atdheun e tyre.

Anëtaret e delegatës jugosllave para se të nisen i bënë korespondentit t'onë këto deklarata:

Nuk përfytyrojmë një çështje që të mos mund të shkoqitet me Turqin midis nesh. Kthehemi në atdhén t'onë duke pasur me vetëhe Konventën që u përket emigrantëve. Këtë konventë të cilën e parafuam së bashku me të ndershmin diplomatin t'uaj Hasan Saka, jemi të sigurtë se Qeveria e jonë do ta pranojë sikur që është. Sasia e emigrantëvet që do të vinë nga vëndi i jonë në Turqi do të jetë më se 250 mijë. Këta janë bujq, punëtore dhe elemente të dobishëm. Mund të theksojmë se në konvente egzistojnë shënime të kjarta për mos dëmtimin me asnjë mënyre të tyre. Çmimi i tokavet dhe i pasunive që do të lënë emigrantët në vendin t'onë u është çmuar e caktuar. Këto të holla do t'i paguhen Shtetit. Transportimi i emigrantëvet shpresojmë se do të fillojë në mbarim të vitit ose në fillim të vitit 1939. Çështja e transportimit nga Jugosllavia e emigrantëvet dhe të instalimit të tyre këtu do të sigurohet nga Qeveria e juaj. Për këtë qysh tash janë duke u-bërë pregatitjet. Drejtori i përgjithshëm i instalimit Dr. Xhevdet i cili kish marrë pjesë në Komisionin me ekspresin e djeshëm u-nis për Ankara. Edhe deputeti i Trabizonit, Hasan Saka, pas disa ditëve do të vejë në kryeqytet».

arritur qëllimin e vetë, Jugosllavia ka bërë haptazi mistifikime në statistikat e popullsis.

Në qoftë se kanë egzistuar dhe egzistojnë ende disa mijëra Turq në tokën e ish-Jugosllavis, këta dallohen lehtazi nga bashkëfetarët e tyre Shqiptarët muslimanë, si nga gjuha ashtu dhe nga zakonet, traditat e nga veshja, dhe gjënden të vendosur në disa zona të vogëla dhe të izoluara midis Manastirit dhe kufirit bullgaro-jugosllav. Mund të numërohen dhe në krahinën e Manastirit disa katunde turq midis katundeve shqiptare. Gjithashtu dhe në krahinën e Shkupit kemi parë se gjënden tre katunde turq (1). Mund të themi pa drojtje se si elementi sllav, ashtu dhe elementi turk janë si ishuj të vegjil në mes të detit shqiptar.

---

(1) Po japim këtu poshtë emrat e gjashtë katundevet turq që ndodhen në rethin e Manastirit: Kenallì, Kanatllar, Nasçitllì, Musà Oba, Budakllar, Elekler.

Katundet turke të ndodhura në rethet e Shkupit quhen Gureler ose Konjare e Madhe e Konjare e Vogël dhe Kojlice.

PJESA

PJESA E IV

KOLONIZIMI JUGOSLLAV NË KOSOVË

Siç dihet botërisht dhe mund të provohet fare lehtë me një kqyrje në vënd ose me statistikat e popullsis, si me ato të huajat ashtu dhe me statistikat zyrtare jugosllave vetë, Kosova etnografikisht është tokë shqiptare dhe historikisht ka qënë kurdohere e tillë.

Realiteti i gjëndjes i ka detyruar Sërbët t'a pranojnë egzistencën e elementit shqiptar në Kosove dhe shumicën e tij dërmuëse. Midis atyre dëshmivet sërbe që kanë një karakter zyrtar kemi përmëndur më sipër librin e Fiduçiarit të Reformës Agrare jugosllave G. Krstiq, me titull *Kolonizimi i Sërbisë Jugore* (1), botuar në Sarajevo më 1928 në shtypëshkronjën « Bosanska Poshta ».

Libri në fjalë është ndarë më tri pjesë: I) Zhvillimi e gjendja II) Gabimet, pengimet e vështirësirat. III) Rëndësia e sukseset. Në fund të librit është si aneks dhe një hart'e kolonizimit.

Realitetin e gjëndjes etnografike të Kosovës e ka pohuar me një shprehje shumë të gjallë vetë autorit në fjalë. Elementi sërb që jetonte midis elementit shqiptar konsiderohej prej vetë Sërbëvet « si rob në detin shqiptar ». « Të gjithë këtë e ndjejnë në shpirtin e nuk e fshehin ». Me gjithë përpjekjet e tyre të shumëta, Sërbët e kuptuan më në fund se nuk ishte e mundur t'a fshihnin realitetin. Kjo gjëndje e pengonte deri diku zbatimin e përpikshëm të urdhëravet foshnjarake të Qeveris jugosllave që me ligjë e regullore përpiqesh t'a çkombësonte Kosovën nga elementi autokton shqiptar.

Në studimin e tij, i lartpërmënduri Krstiq bën përshkrimin e krahinavet të ndryshme të Kosovës simbas rastit. Po paraqesim disa shëmbuj:

« Në rejonin e kolonivet kosovare është edhe ajo e Gjilanit. Kjo është një prej nënëprefekturavet më të mëdha si në sipërfaqe ashtu

(1) Përkthyer në shqip prej Z. Rrok Maloki.

dhe popullsi. Është e banuar më të shumën prej Shqiptarësh. Sërbë vëndas ka fare pak, dhe këta nga pikëpamja shoqërore të nënështruem... » (faqe 10).

Në faqen 37 këndohet: « Duhet ditur se në nënëprefekturat e Gorës dhe Hasit ka gjithësejt shtatëqind frymë sërbë, në nënëprefekturën e Podrimës, me qëndër Orahovacin (Rahova) nga 4.500 shtëpi ka vetëm 500 sërbë, e në nënëprefekturën e Podgorës mbi 14.000 frymë kanë qënë sërbë më 1920 gjithësejt 1.900. Vetëm në nënëprefekturën e Shardagut — me përjashtim të Komunës së Prizrenit që ka 4.650 frymë sërbë — nga 17.127 kanë qënë sërbë 6.268 ».

Këto shifra sa do të favorëshme që mund të duken për elementin shqiptar, prapë nuk janë objektive.

Në faqen 78, autori jep një pasqyrë të popullsis në Kosovë dhe e nxjer si vijon: « për gjëndjen e elementit t'onë kam data të sakta vetëm për krahinën e Kosovës. Nga 25.407 shtëpi në krahinën e Kosovës nga viti 1919 kanë qënë sërbë vetëm 6.311 dhe këto 5.601 ortodoksë, 710 katolikë dhe 330 jevgj ortodoksë. Turq, Shqiptarë, muhaxhirë e e jevgj muslimanë atë vit kanë qënë 18.544 shtëpi. Emigrantë kanë qënë vetëm 42 shtëpi e 50 kanë qënë nga ata që e kanë blerë tokën. Në përqindje atë vit kanë qënë 24 % Sërbë, 72% Muslimanë (Shiqptarë, mbassi në Kosovë nuk ka Turq), 3,5% Jevgj dhe 0,5% Çifutë.

Më poshtë thuhet: « Në Kaçanik, në mes të cilit kalon hekurudha nga Shkupi për në Kosovë sidhe e vetëmia rrugë që bashkon këto të dy krahina t'ona në Sërbinë Jugore, është një gjëndje edhe më e pakënaqëshme. Mbas statistikës së vitit 1921 kanë qënë në këtë krahinë vetëm 2,33% Sërbë dhe kusuri të gjithë Shqiptarë ».

« Gjëndjen e elementit t'onë në krahinën e Prizrenit e kemi përmëndur në pjesën e parë. Në përqindje kanë qënë më 1921 në këtë krahinë Sërbë vetëm 17%, nga të cilët në qarkun e Podrimës 14%, të Gorës 5,5%, të Hasit 0%. Vetëm në atë të Shardagut (Prizrenit) kanë qënë 33% ».

« Po kjo gjëndje është dhe në Metohi (Fusha e Pejës dhe e Jakovës). Edhe atjé kanë qënë vetëm 17% Sërbë, por në një pozitë shumë më të vështire sepse Shqiptarët kanë qënë më agresivë. Sërbët këtu edhe në veshje janë përnjisuar me Shqiptarët sa që nuk jemi në gjëndje t'i njohim. Të gjithë dinë shqip e sërbishten e flasin me aksent shqiptar; të përbashkëta kanë qënë edhe shumë zakone martese. Për

tezën t'onë është me rëndësi të shënojmë që nga 17% të përmendur, i takojnë nënëprefekturës së Jakovës vetëm 3%, kurse kusurin e kanë përbërë 16% Shqiptarë katolikë dhe 80% muslimanë ».

Këtu vëlen të vihet në dukje një pikë me rëndësi. Thotë autori i ynë me lart së të gjithë Sërbët e Metohis dinë shqip e sërbishten e flasin me aksent shqiptar; të përbashkëta kanë qënë edhe shumë zakone martese. Ky është një konstatim shum'i çmueshëm dhe nuk mund t'a kalojmë në heshtje; sepse ata Sërbë që e flasin sërbishten me aksent shqiptar dhe kanë zakone si të Shqiptareve, nuk janë tjatër veçse Shqiptarë të sllavizuar nga propaganda sërbe dhe nga influenca panslave e Rusis cariste, nga politika prepotente e konsujvet rusë e sërbë, nga kisha dhe shkollat sërbe, të cilavet Qeveria otomane u kish pas lënë dorë të lirë në Turqin e Evropës. Sikur ata sërbë të kishin qënë sërbë-gjysme-të-shqiptarizuar, siç don të insinuojë autori në fjalë, do të flisnin shqip me aksent sërbisht dhe jo sërbisht me aksentin e shqipes.

Prandaj shumë Shqiptarë ortodoksë figurojnë në statistikat sërbe si sërbë dhe zbriten kështu nga numëri i vërtetë i Shqiptarëvet. Po për këtë arësye duhet t'a konsiderojmë numërin e Sërbevet, që autori në fjalë tregon në shifrat e cituara më sipër, tepër t'egzazheruar sepse në sasin e Sërbëvet përfshin dhe Shqiptarët ortodoksë, katolikët shqiptarë, Malazestë, Shqiptarët muslimanë të sllavizuar.

Nga ana tjatër, duhet vrejtuar se Sërbët vëndës, do më thënë ata që ndodheshin në vënd para vitit 1912, kanë jetuar kurdoherë në harmoni me Shqiptarët dhe shumë herë janë bashkuar më 'ta për të lëftuar kolonistat sërbë që vendoseshin pas vitit 1912 e pas vitit 1920. Por autori, me qëllim që të zhvillojë ndjenjat jugosllave dhe sërbizimin e elementit sërb vëndës, thotë se sa më tepër kolonista të ketë, aq më teper do të forcohet ndjenja e sërbëvet të vëndit, dhe do t'i çlirojë ata nga influenca e Shqiptarëvet.

Më poshtë autori sërb shkruan: « Statistika e jonë në Kosovë refen se né në pikëpamje kombëtare kemi pas rezultate të mëdhà. Kjo është prapë gjithënjë e vogël, pse në fund të vitit 1927, elementi kombëtar i jonë në krahinen e Kosovës ka mundur të shtohet nga 24% të vitit 1919 vetëm në 37% të popullsis së përgjithëshme. Nga 24.444 shtëpi ka sërbë 10.286, muslimanë 59%, Jevgj 3,5% e çifutë 0,50% ».

Në nënëprefekturën e Labit autori pohon se më 1913 nuk ka pasur asnjë shpirt sërbi, kurse nga ajo datë e tëhu, nga një anë emigrimi i Shqiptarëvet dhe nga ana tjatër kolonizimi sërb i kanë ndruar pamjen etnike asaj krahine.

Këto janë pohime të cilat e ilustrojne qartazi politiken e kolinizimit jugosllav dhe të çkombëtarizimit të krahinavet shqiptare të Kosovës.

Qëllimet e Kolonizimit Jugosllav. — Përpara një gjëndjeje të këtillë, që tregon se popullsia shqiptare në Kosovë e në Metohi formon shumicën dërmuëse, Qeveria sërbe filloi pas vitit 1912 t'i kolonizojë ato vise me Sërbë e Malazes, Herzegovinas, Boshnjakë e Banatas, dhe këtë program do ta zbatonte sistematikisht pas vitit 1920; për këto arësye autori i jone thotë: «...kolonizimit i kam dhënë radhën e ndërmarrjes shtetnore të klasit të parë».

Përveç qëllimit kryesor të kolonizimit, autorietet jugosllave kanë pasur ndër sy të kënaqnin me anën e kolonizimit edhe elementet sërbë e malazes që kishin punuar dhe ishin sakrifikuar në luftën botnore për krijimin e Sërbisë së madhe. Këta elemente përbëheshin sidomos prej çetnikësh, kryetarë çetash e shokët e tyre, të cilëvet u-dorëzoheshin tokat e Shqiptarëvet në bazë të ligjës së kolonizimit dhe të reformës agrare.

Kolonizimi jugosllav ka pasur sidomos për objektiv Kosovën, Metohin dhe Krahinën e Shkupit, në të cilat vise është zbatuar në shkallë të gjerë, kurse në viset e ndodhura më në Jugë, në t'ashtuquajturën Maqedhoni, gjënden fare pak kolonira jugosllave, të shpërndara në rethet e Manastirit dhe disa në rethet e Ohrit.

Kolonizimi kishte si konsekuencë të parë shpërnguljen e elementit shqiptar, mbassi asimilimi i këtij nga sërbët, ishte i pamundur dhe autori sërb vetë e sheh këtë sot për sot të parealizueshmë.

Kolonizimi jugosllav kishte gjithashtu për qëllim që të siguronte rendin publik në Kosovë e në Metohi, mbassi Shqiptaret, si do ta shohim dhe më poshtë, aratiseshin dhe i sillnin një pengim shumë të madh kolonivet sërbe dhe autoritetevet.

Midis së tjeravet ka qënë edhe qëllimi ekonomik, mbassi toka e Kosovës është shumë pjellore dhe e përshtatëshme për bujqësi e blegtori.

Si një nga parimet që duhen marrë për bazë për zhvillimin e kolonizimit jugosllav Fiduçiari i Reformës Agrare në Shkup jepte edhe këtë këshillë: «Duke ruajtur dispozitat ligjore, me rigorozitetin me të madh të kufizohen dhe të ndahen për qëllime kolonizimi gjithë komplekset për të cilat çfaqet nevoja etnografike dhe justifikimi ekonomik».

Sa e sa padrejtësira dhe vepra arbitrare u-kryen kundër elementit shqiptar në bazë të këtyre parimeve, sepse qëllimi kryesor ka qënë ekspansionizmi jugosllav, sidomos në dëm të elementit shqiptar, dhe autori sërb pohon se në Metohi (fusha e Pejës e Jakovës) dhe në Kosovë, posë aresyevet ekonomike kanë qënë gjithashtu arësye kombëtare në radhën e parë. Ky qëllim nuk mund të realizohej veçse me kolonizimin jugosllav të Kosovës dhe me çdukjen e elementit shqiptar.

Rezultatet e kolonizimit Jugosllav në Metohi e Kosovë — Një nga veprat e para të Qeveris jugosllave, ka qënë regullorja e kolonizimit të visevet jugore me datë 24-IX-1920. Çështja kishte tepër rëndësi dhe nuk mund të lihesh për më von. Në bazë të regullores në fjalë caktoheshin toka për kolonizim:

1) Tokat shtetnore të lira.

2) Tokat e lëndinat e bashkivet e katundevet, deri sa këto të kenë përmbushur nevojat e tyre për kullota.

3) Tokat e shkreta dhe tokat që pronarët i kanë braktisur për gjithëmonë.

4) Tokat, të cilat me urdhënime të mëparëshme për zbatimin e reformës agrare (paragraf. 9) dhe regullores mbi çpronësimet pjesërisht të tokave me datë 12-II-1920, mund të ndahen nga pronat private.

Me një regullore kaq gjenerike dhe elastike, kishte mundësi për autoritetet e reformës agrare që t'u grabitnin tokat Shqiptarëvet, sidomos po të merret parasysh se pronarët nuk kanë qënë të pajosur me tapi simbas zakonit të përgjithëshëm në kohën e regjimit otoman.

Me këte regullore konfiskoheshin për qëllime kolonizimi edhe tokat e t'ikurvet dhe të kaçakëvet dhe tokat e kullotat e katundevet

shqiptare: Duhet vënë në dukje sidomos shprehja toka shtetnore të lira e cila është tepër elastike.

Disa shifra: Simbas statistikës së shërbimit teknik të Besimtarit Kryesor të Reformës Agrare të Shkupit, gjer më 1-1-1928 janë kufizuar me qëllim kolonizimi 225.397 ha toka ndër 1923 komplekse. Prej kësaj toke janë rimatur 143.724 ha e janë ndarë vetëm 111.602 ha; kurse kusuri ka mbetur në kontestim.

Sipërfaqja e ndarë, prej 111.602 ha, përfshin 173 koloni e 419 troje më të vogëla dhe është ndarë kështu:

1) Kolonistëvet, vullnetarëvet dhe çetnikëvet 43.861 ha ndër 6.250 shtëpi.

2) Vëndësvet 18.173 ha ndër 5000 familje.

3) Pronarëvet në ndërrim simbas art. 27 të regullores mbi kolonizimin 1.149 ha ndër 107 familje.

4) Autoritetevet ushtarake, shkollavet dhe institutevet umanitare të ndryshme, 1.604 ha ndër 190 vënde.

5) Pronarëve të lënë po në vëndin e kufizimit 24.556 ha.

6) Për nevoja kullotje janë lënë 17.839 ha, kurse për rruga, lumenj e ndërtesa kanë mbetur 4.420 ha.

Kolonit jugosllave në Kosovë klasifikohen si më poshtë:

SASIA E KOLONIVET TË THEMELUARA GJER MË 1925

Krahina:	Koloni të mëdha:	Koloni të vogëla:
Graçanica	24	22
Labi	20	35
Vuçiterni	15	67
Gjilani	10	22
Nerodima	9	23
Shkupi	10	12
Zhegligovë	10	19
Peja	11	34
Jakova	10	17
Drenica	7	25
Fush 'e Buellit	4	3
Manastiri	1	18
Ohri	1	2

LISTA E KOLONIVET MË VITIN 1928

Krahina	Emri i kolonis	Numri i kolonëve	Kombësia dhe origjina e kolonëve
Peja	Vitomiricë	130 shtëpi	Malazes
Jakova	Lug Bunar		Herzegovinas
Istoku	Dy grupe	30 familje	Banatas
Drenica	Serbicë		Malazes e Herzegovinas
Presheva	Cakanovac	27 familje	Sërbe e Maqedhonas
Presheva	Trnasvka Reka	11 shtëpi	Malazes
Kumanova	Tabanovce		Banatas Ljugodrag
Shkupi	Ognjanci		Sërbë
»	Rzhanicani		Sërbë
»	Dushanovac		Herzegovinas
»	Lisicija e sipërme		Të ndryshëm
»	Hasanbeg		Turq'e sërbë
Kaçaniku			Herzegovinas
Tetova	Ropotovë		
»	Berveniçë	19 familje	Sërbë çetnikë
		5 «	Herzegovinas
Velesi	Otavicë	13 »	Banatas e Boshnjakë
Manastiri	Kragujevac		
»	Ribac		
»	Xhermijan		Dalmatas
Ohri		12 kolonë	
Prizreni	Kleçkoviq	37 familje	Sërbë
Suha Reka	Gjinovca		
» »	Shirokovë		
Prizreni	Ura e Shvankës		Malazes, Sërbë e Herzegovinas
Gryka e Cernalevës	Hani i Dulës		
Drenica	Krikovo		
Drenica	Stankovci		
Drenica	Sërbicë		Malazes e Herzegovinas
Prishtina	Podujevo		

Këto koloni kanë qënë themeluar gjer më 1925. Nga viti 1925 është punuar më tepër në përmbushjen e kolonivet të vjetëra.

Në Metohi është vendosur krejtësisht elementi malazes, i përbërë më shumë prej barinjsh, të cilët nuk janë bujq të mirë.

Në listën e dytë autori sërb nuk ka shënuar të gjitha kolonit. Duket ka treguar vetëm ato më të rëndësishmet dhe më të përparuarat.

Nga ana tjatër, autori i jonë shprehet në këtë mënyre mbi gjëndjen e përgjithëshme të kolonivet jugosllave:

« Prej të gjitha kolonivet kanë pasur sukses dhe kanë përparuar më tepër kolonit në Kosovë. Atje është toka shum'e mirë e veçanërisht gjatë lumit Sitnica e sidomos në Nënëprefekturën e Vuçiternit. Gjëndja klimatike e mirë. Ujët e mirë e të bollshëm. Komunikacione të mira e të mjaftueshme. E meta e vetëme është se nuk ka pyje e prandaj ernat e mëdha që sundojnë, formojne rezik për farnat. Në Kosovë është vendosur elementi më i mirë i jonë dhe jo vetëm nga një krahin 'e Shtetit por nga të gjitha anët. Ndodhen koloni omogjene si dhe koloni të përzieme. Të gjitha kolonit pothuajse qëndrojnë mirë. Kolonistat janë katundarë të vërtetë të cilët kanë ardhur të punojnë dhe i kanë ditur të gjitha mundimet që i presin. Për një kohë të shkurtër kanë arritur suksese të mira. Të pakët janë që nuk kanë ngrehë shtëpi e disa i kanë zëvëndësuar të vjetërat më të rea. Shtëpit i kanë moderne e të ndërtueme mirë pas higjienës. E kanë ndjerë po edhe nevojën e pyllëzimit, jo vetëm për drú zjarri, por edhe për mbrojtjen e bimëvet nga ernat. Tokën janë duke e punuar mjaft racionalisht e disa kanë sjellë edhe vegla të ndryshme bujqësije. Si shëmbëll të zhvillimit ekonomik e të gjëndjes do të sjell deklaratat e një fare Gavrilo Tepaçeviq nga Piva, i cili pyetjes s'ime se si shkonte m'u-pergjegj: « Ja si jam. Gjyshi im Joja Pejov Tepaçeviç bisedonte me mburje kur kishte një mijë kilogram grurë e unë në këtë vitin e thatë (1927) do të kem një vagon ».

Këto janë arësyet kryesore të cilat së bashku me qëllimin e ekspansionizmit në dëm të elementit shqiptar shkaktuan kolonizimin sistematik të Kosovës me elemente jugosllave.

Në disa koloni janë vendosur sllavë nga më të zhvilluarit e më të mësuarit si Ballancanë, Sllovenë, Banatas, Herzegovinas. Janë

shpesh të kulturuar dhe kanë sjellë me vetëhe vegla bujqësore moderne, mobla të mira dhe të holla.

Kolonit me element të perzier kanë përparuar më tepër nga kolonit me element omogjèn.

Efektet e kolonizimit jugosllav në disa krahina kanë qënë shkatërruëse për kombin shqiptar. Kështu autori sërb përgëzohet, kur konstaton: «Në Nënëprefekturën e Labit ku më 1913 nuk ka pas asnjë shpirt sërbi, kolonizimi i jonë e me këtë emigrimi privat e ka ndruar pamjen etnike të të gjithë qarkut...».

Në Metohi kolonizimi nuk ka dhënë aq fryta të mira sa ka dhënë në fushën e Kosovës për shkak të mungesës së ujit të pijshëm e për vaditje. Ishin pregatitur për këtë qëllim plane kanalizimi. Në Metohi kanë qënë vendosur sidomos Malazes, të cilët nuk u-treguan bujq të mirë dhe preferonin të kalonin kohën duke spenzuar në qytetet e afërme (Pej'e Jakovë) se sa të punonin. Me gjithë këtë, simbas mendimit të autorit sërb, Malazest bashkëjetojnë më mirë me Shqiptarët se sa elementet e tjerë, sepse merren vesh më lehtë, kanë zakone të njëjta dhe janë një racë e mësojnë shqip si Shqiptarët.

Përsa i përket krahinës së Manastirit, bilanci i kolonizimit jugosllav aty ka qënë pasiv.

Gjithënjë për sa i përket rezultatevet të kolonizimit, midis së tjeravet autori sërb thotë: «Në mes të pasojavet direkte dhe indirekte të kolonizimit t'onë është edhe zhvillimi i qytetevet. I pari pas radhës vjen Shkupi. Ky qytet diçka me anën e kolonizimit direkt (1) e diçka me zhvillimin e nevojavet e shtimin e kolonëvet t'onë përqark sidhe ndër vise më të largëta ka marrë një hov sa e ka dyfishuar popullsin e vetë dhe është bërë qëndre tregëtare kryesore për gjithë Sërbin jugore. Po këtë gjë e shohim dhe ndër qytete të tjerë, qoftë edhe në masë më të vogël. Presheva, dikur qytet thjesht turk (autori sërb gabon kur e quan turke popullsin e Preshevës sepse vetë statistika jugosllave e vitit 1921 mbi 17.673 frymë myslimanë pranon shprehimisht 15.479 Shqiptarë), sot ka gati gjysmën e shtëpivet sërbe. Kumanova diçka me kolonizim e diçka me blerje pasunish, po fillon të marrë një pamje qyteti modern e të përparuar.

---

(1) Pas prishjes së Jugosllavis Serbët e ardhur në Shkup për kolonizim janë larguar dhe shumicën e popullsis vëndëse sot në qytet e përbëjnë Shqiptarët.

Uroshevaci (Ferizaj) nuk është më qyteti shqiptar i dikurshëm; qysh sot një shumice kolonistësh herzegovinas e ka rethuar e nuk do të shkojë shumë kohë që t'a sundojë fare qytetin. Prishtina parashihet të bëhet një qytet modern e shum'i përparuar. Peja e dikurshme, ku mezi mund të shihesh ndonjë njeri i jonë, sot vëlon me kolonë. Ata i japin këtij qyteti jetë. Ata me kohë do t'ia ndryshojmë edhe karakterin. Qytetet në Maqedhoni ende s'e kanë ndjerë ndodhjen e kolonëvet pse të pakët në numër.»

Për gjashtë muajt e parë të vitit 1928 janë vendosur në Kosovë, thotë autori sërb, 938 familje nga të cilat vetëm në rejonin e Prishtinës janë instaluar 552. «Po të vërejmë se njëkohësisht në qarkun e Pejës po kryhen punimet më intensive reth kolonizimit të organizuar ndër tokat disponibile e se edhe këtu gjer më dhjetor janë vendosur nja 1.700 familje, atëhere me siguri mund të llogaritim se gjer në fund të vitit 1928 numëri i kolonëvet do të hypë më 2.500 familje. Ç'ka do të thotë më tepër se një e treta e numërit të përgjithshëm të tetë vjetvet».

Në vijat e përgjithëshme, autori sërb thotë se vepërimi kolonizues jugosllav, si mision kombëtaro-agrar, nuk ka mbërrit as gjysmën e rrugës edhe propozon një vepërim më energjik e intensiv.

Rezulltatet e kolonizimit jugosllav në Kosovë dhe në Maqedhoni janë përshkruar dhe prej autorit frances Jacques Ancel në librin e tij *La Macédoine* (Paris 1930).

Jugosllavët, çështjen e kolonizimit të krahinavet shqiptare e kishin marrë me gjithë shpirt, e kishin filluar sistematikisht që më 1921, duke përdorur kolonistë nga më të mirët, të cilët gëzonin ndihmën materiale dhe morale të plotë të autoritetevet jugosllave. Për këtë qëllim kishin shpërngulur nga Sërbija, Herzegovina dhe Banati, katundare që në realitet nuk kishin nevojë të lakmonin toka të tjera sepse kishin vënde mjaft të mira, dhe i dërgonin në Kosovë me premtime të shuma dhe duke ua përshkruar Kosovën si një parajs tokësor ku do të pasuroheshin.

Më gjithë këtë rezultati ka qënë relativ dhe nuk dhà kurrë frutat e dëshëruara sepse elementi sllav i infiltruar në këtë mënyrë në Kosovë e në Metohi mbeti si një ishull i vogël midis detit shqiptar. Elementi shqiptar, sado i shtypur, i persekutuar dhe i varfëruar nga grabitjet sistematike të autoritetevet jugosllave, ka treguar një

gjallëri të atillë sa që ka mbetur i paprekur si në sasi ashtu dhe në fuqin e tij morale.

Ky është realiteti të cilin vetë autori i librit të kolonizimit detyrohet ta njohë me këto fjalë: « Edhe pse me kolonizimin në Kosovë në pamjen e parë mund të jemi të kënaqur, edhe pse tjegulla e kuqe e shkruan tanë fushën e Kosovës, prapë është réfyer se Kosova akoma nuk ësht'e jona ».

Pengimet e takuara nga kolonizimi Jugosllav dhe reaksioni i elementit shqiptar. — Kolonizimi jugosllav, me gjithë efektet e tij shkatërronjës për elementin shqiptar në Kosovë e në Metohi dhe me gjithë që arriti ta ndryshonte deri diku fizionomin shqiptare të disa krahinave, nuk dhà kurrë perfundimet e dëshëruara prej Qeveris jugosllave dhe prej shovenëvet sërbë. Siç e pamë edhe më lart autori i librit mbi kolonizimin në vitin 1928 veprën e filluar prej Reformës Agrare e konsideron se ka arritur vetëm në mes të rrugës, dhe prandaj jep shumë këshilla e bën shumë rekomandime për përmirësimin dhe zhvillimin e metodavet të zbatimit të Reformës agrare dhe të kolonizimit.

Plani i kolonizimit dhe masat e marruna për aplikimin e tij gjenin shumë lloj pengime dhe punët nuk shkonin kurrë ashtu siç dëshërohesh prej autoritetevet. Pengimi i parë ka qënë kundërshtimi i natyrëshëm i popullsivet vëndëse që e konsideronin kolonistin si një të huaj e si një grabitës. Kundërshtimi kundër kolonistëvet vinte dhe nga ana e vëndësvet sllavë, mbassi këta ishin mësuar të bashkëjetonin me elementin shqiptar, shumë herë flisnin shqip, kishin zakone të njeta dhe jetonin në marrëvëshje të plotë me 'të; nuk e shihnin me sy te mire ardhjen e elementit te ri sllav, edhe pse ky sillte me vetëhe një mëndësi të veçantë, dhe ushqente ndjenja sllave shumë të gjalla, dhe kishte njëkohësisht për mision të ngjallte dhe të forconte ndjenjat e sërbevet vëndës. Kolonisti ishte gjithashtu për ata një rival që e punonte tokën me metoda dhe me vegla të rea, kishte përkrajen e Stetit dhe vendosesh në tokat më të mira, të lëna prej Shqiptarëvet emigrante o të arratisur, toka të cilat i lakmonin vetë vëndësit.

Pengimi më i madh vinte nga ndodhja në vënd e elementit shqiptar kompakt dhe në sasi të konsiderueshme. Qëllimi i koloni-

zimit ka qënë prandaj të shdukte sidomos «detin shqiptar» ku pothuaj mbytesh elementi sërb vëndës, e sidoqoftë synonte të krijonte një gjëndje demografike që mund të ekuilibronte proporcionin midis elementit shqiptar e elementit sllav.

Prandaj rezikun më të madh e ndjenin Shqiptarët, të cilët që në fillim e kuptuan se elementi sllav lakmonte tokën e tyre dhe bilé edhe vatrat e tyre. Me një herë filloi emigrimi sidomos nënë kërcënimin dhe ndjekjet e autoritetevet të vëndit, u-krijua një kurent emigrimi i vazhduar në drejtim të Turqis dhe kur kish mundësi edhe për në Shqipëri. Po shumë Shqiptarë, në të cilët dashuria e tokës ishte rënjosur tepër thellë treguan një shpirt sakrifice më të madh: u-aratisën nëpër malet e Kosovës, jetuan vjet me radhë nëpër bjeshkët e ftohta, duke zbritur herë mbas herë në fushë fshehurazi që të gjuanin të huajin që kishte robëruar vëndin e tyre dhe të prisnin komunikasionet. Rrugët ishin bërë të pakalueshme për Sërbët, që u-detyruan më në fund të vendosin poste gjandarmerije të shumëta dhe të dëndura. Episodet heroike të Shqiptarevet janë të panumërta dhe do t'i nxjerrim nga libri i kolonizimit të lartpërmëndur.

Krahina e Gjilanit, thotë autori sërb, «është e përmëndur në koherat e para nga vepërime kaçakësh, të cilët edhe sot gjejnë jatakë të besueshëm. E vetëmia nënëprefekturë ku çetat e kaçakëve nuk kanë mundur të çduken. Duke marrë parasysh gjerësin e kësaj nënëprefekture, mund të thuhet se gjer në kohët e fundit ka qënë e papërkitun nga kolonizimi».

Një epizod me rëndësi për të provuar shpirtin e sakrificës dhe rezistencën që kanë treguar disa shqiptarë në Kosove është dhe ky që vijon; t'ia lëmë fjalën më mirë sërbit vetë:

«Baras me kolonizimin e Metohis, po zhvillohet dhe kolonizmi i Drenicës. Kjo është krahina më e butë e jona. Drenica mbas natyrës së saj është një lloji me Krajinën e Bosnjës, prandaj Krajinasit ngasin mbas saj. Në kohën e kolonizimit t'onë në Drenicë ka sunduar më fort edhe pasiguria më e madhe. Ka qënë një kohë kur nuk egzistonte fare autoriteti shtetnor. Kaçaku i përmëndur Azem Bejta ka qënë sunduesi i vërtetë i Drenicës. Kaq popullor ka qënë në mes të Shqiptarëvet sa që — për turpin e autoritetevet shtetnore të atëherëshme — populli ka qënë i shtrënguar t'i ndërtonte kullën me angari.

Ndër të tilla rethana është zbatuar kolonizimi në Drenicë. Vetëm mbas vrasjes së Azem Bejtes më 1924, kur ka intervenuar dhe ushtëri me top, ka filluar një koh'e ré për kolonizimin dhe për jetën e emigrantëvet ».

« Pasigurimi në Drenicë ka shkaktuarë edhe ndërtimin e kolonis Sërbicë ». Më von Sërbët emërin Sërbicë i a ngjiten të gjithë krahinës së Drenicës.

Më poshtë këndojmë: « Interesat e rendit publik kanë imponuar që t'i jepet më tepër kujdes edhe asaj pjesë se Drenicës, e cila shtrihet gjatë rrugës kryesore Mitrovic'e Kosovës-Pejë. Kjo pjes'e rrugës është fare e shkretë dhe e pasigurtë, pse aty janë shtegjet kryesorë të kaçakëvet ». Ministria e Reformës Agrare kishte vendosur që t'u jepte falas emigrantëvet kolonistë që do të vendoseshin aty shtëpira të forta prej guri, puse të çelur dhe një ndihmë prej 5.000 dinarësh.

« Në krahinën e Prizrenit nuk duhet lënë mbas dore edhe fakti që rendi publik është mjaft i cenuar. Këtë e provojnë postet e shpeshta të gjandarmëris e rrojet gjatë gjithë rrugës së lartpërmëndur ». Udha për të cilën bëhet fjalë është ajo që lidh Stimljen me Prizrenin dhe nga njera dhe tjetra anë e rrugës gjer te Ura e Shvankës, ku ndodhet një koloni Malazesësh, rrinë komplekse të mëdha të pafrytëzuara.

« Këto janë kalara të vërteta, vazhdon të thotë autori sërb, për postet e gjandarmëris. Tanë janë rethuar me llogore e janë pajosur me podrume të thellë ».

Një epizod tjatër i përgjakshëm është « Kryengritja e Labit » që ndodhi më 1920 dhe u-shtyp prej Nënkolonelit Radovan Radoviq « në mënyrë që në Prapashticë, që ishte çerdhja e kryengritjes, nuk mbeti asnjë shtëpi e shëndoshë dhe e padëmtuar. Mbas intervenimit të Ministris së Brëndëshme e mbas urdhërit të Ministris së Reformës Agrare, autoritetet agrare në vëndet e familjevet të prishura e të ikura vendosnë 22 familje prej Jablanice (Malazes) të cilet nënë rezikun personal më të madh e vazhdimisht me pushkë në dorë kanë jetuar dhe e kanë mbajtur atë krahinë gjer më 1923, gjer sa u-shtyp edhe mendimi më i fundit për kryengritje ».

Me rezistëncën e tyre të vazhduar dhe me ngjarjet e përgjakë-

shme në të cilat ranë viktima, shqiptarët e Kosovës kanë shkruar një kapitull të ri të historis së Shqipëris, sepse e bënë të dështojë programin e kolonizimit jugosllav në Kosovë, program i cili ka qënë një veprë kundër çdo parimi njerëzor dhe kundër qytetërimit të shekullit të XX.

ANEKSE

Shumica e anekseve që vijojnë janë tekste të nxjerra nga autorë të huaj dhe për mos cenuar vlerën e tyre i botoj më në gjuhën origjinale dhe pa komente të gjata

LUMO SKENDO

ALBANAIS ET SLAVES

Lausanne, 1919

Page 4. — Et là où ils ont découvert un seul Slave, un seul village, si infime qu'il fut, ils n'ont point hésité à déclarer slave toute la région.

Et pour donner plus de poids à leur politique — car de fait il ne s'agissait que d'une préparation pour le grand slavisme — on a inventé un terme géographique, celui de *Stara Serbia* (vieille Serbie) pour désigner une bonne partie de l'Albanie Septentrionale. Nous disons inventé, car ce nouveau terme ne figure pour la première fois qu'en 1845, dans la « Carte de la principauté de Serbie » par Jean Bukarsky, imprimée en cette année-là à Belgrade, et où la région de Bielopolje, au sud ouest de la Serbie est designés sous le nom « Ancienne Serbie, ou Albanie actuelle», tandis que dans la géographie de Vouk Karadjitch, imprimée également à Belgrade, en 1827, un pareil terme ne figure point (1).

Et les autres cartographes et géographes de suivre machinalement cet exemple!...

Page 15. — Les auteurs slaves ont recours à un truc trop connu par ceux qui ont étudié les rouages de la propagande nationaliste dans les Balkans et surtout employé avec une égale indiscréption par les Grecs, à savoir de vouloir faire passer pour *Turcs* les Albanais musulmans et de la sorte vouloir diminuer leur nombre. Or quoique dans les grands chefs lieux tels que Prishtina, Uskub, Monastir, les Albanais entendent ausssi le turc — comme les Bulgares eux-mêmes d'ailleurs — il n'y a aucun doute sur leur véritable nationalité qui est l'albanaise. Le même Jordan Ivanoff convient de cela et recon-

---

(1) Voir Ichirkoff, « Prinos kem etnografiata na Makedonskite Slavini » (en bulgare), Sofia 1907, page 9.

nait que la population musulmane de Bitolja (Monastir), Ohrida, Struga, Uskub, etc., est principalement composée d'Albanais (1).

Page 19. — L'Echo de Bulgarie de Sofia, dans une étude qu'il consacrait à Dibra, dans l'un de ses premiers numeros de la première année de sa publication (1913), reconnaissait que « sous l'influence de la propagande active des Bulgares, non seulement les Slaves de Dibra, mais aussi les Albanais chrétiens ont commencé à se dire bulgares ». L'auteur bulgare Jordan Ivanoff dit que « à Gostivar la population albanaise chrétienne s'est bulgarisée à côté de la minorité bulgare ».

Nous reproduisons plus loin, page 32, le passage de *l'Echo de Bulgarie.*

Page 32. — L'organisation religieuse des Slaves leur a fort souvent donné un avantage vis à vis des Albanais, semblable à celui qu'ont eu les Grecs jusque vers la fin du XIX siècle: les Albanais orthodoxes ayant été obligés de fréquenter les églises et les écoles slaves — serbes ou bulgares — ont très souvent passé pour tels et leur nombre a servi à augmenter celui des Slaves. C'est là, ainsi que nous l'avons indiqué plus haut un processus inverse de celui que les savants slaves ont voulu appeler « l'albanisation des Serbes ». Cela explique pourquoi les voyageurs et ethnographes n'ont pas voulu voir dans le nord et l'est de l'Albanie que des Albanais musulmans et catholiques, les orthodoxes étant confondus avec les Slaves. Les Slaves eux-mêmes reconnaissent qu'ils ont fait une propagande acharnée par leurs écoles et leurs Eglises, tendant à donner une illusion fausse de l'état ethnographique, sinon à en changer le caractère. Voici ce qu'on lit dans le journal *Echo de Bulgarie* de Sofia, première année (1913) N. 4, page 2, à propos de Dibra:

« Bien que seule pépinière de lettrés bulgares dans la contrée, le monastère de Saint-Jean Bigor, est parvenu non seulement à maintenir la langue et le service religieux bulgare dans les villages bulgares purs en leur envoyant des maîtres d'écoles, des curés, des chantres, des iconographes, mais il est arrivé même à exercer une influence sur la population albanaise pure de cette région, de sorte que les Albanais orthodoxes de la région de Gorna Réka (Réka su-

(1) Jordan Ivanoff: « Bigarite v'Makedoniya » (en bulgare), Sofia 1915 p. LXIII.

perieure) se servaient dans le passé et se servent encore aujourd'huj du slavo-bulgare dans leurs églises et même, il y a 40 ou 50 ans, parlaient bulgare entre eux ».

Page 34. — Voici à présent ce que dit le célèbre et si consciencieux voyageur, Ami Boué, sur le Pays qu'habitent les Albanais, pays qui comprend non seulement les régions couvertes par les vilayets de Janina, Shkodra, Monastir et Uskub, mais encore des parties qui ont été données au Royaume serbe à la suite de la guerre turco-russe (1877) par le Congrès de Berlin et malgré les protestations des Albanais. Laissons parler Ami Boué lui-même:

« Les Shkiptars (habitants des Rochers) ou Albanais sont estimés par les statisticiens à 1.600.000 âmes, estimation raisonnable et plutôt au-dessous qu'au dessus de la réalité quand on pense qu'ils s'étendent depuis l'Epire jusque dans la partie occidentale de la Moesie supérieure, où ils se mêlent avec les Serbes, dans la plaine entre Prizren et Ipek, entre Vrania et Mitrovitza, tandis qu'ils occupent presque à seuls, sous le nom d'Arnaoutes, le pays aux sources de Lepenatz, les environs de Tzernoleva-Rieka, le bord sud ouest de la plaine de Prishtina, la contrée entre Vrania, Novo-Brdo, Prishtina, Kratovo, Kourchoumli, Prekoplje et Medoka. D'autre part ils se mêlent aux Bosniaques dans les montagnes entre l'Albanie et la Bosnie, comme à Kolashin, sur la Tora, à Goussinié, à Plava, sur les bords supérieurs de l'Ibar près de Rojai, dans le district Souodol, et ils s'avancent même jusque sur les plateaux à l'ouest et au sud-ouest de Novi-Bazar. Dans le district de Zeta, le long de la Moratcha et dans celui de Clementi, sur le Zem, ils se mélangent aux Monténégrins (1) ».

Page 35. — ...revenons à présent aux auteurs étrangers qui ont étudié les régions qui nous interessent. Voici un autre savant, Georg von Hahn, celui qu'on considère généralement comme une autorité sur les choses albanaises.

La carte qui accompagne ses *Albanesische Studien* (Jena 1854) comprend la totalité des territoires des quatre vilayets de Janina, Shkodra, Monastir et Uskub, et dans la première page de son ouvra-

(1) « La Turquie d'Europe », Ami Boué, Paris 1840, vol. II, p. 13.

ge l'auteur a soin de nous dire que l'Albanie s'étend du 39 me degré de latitude nord au 43me, ç'est à dire de Preveza à Novi-Bazar.

Nous regrettons de ne pouvoir rapporter ici la passage du livre de G.v. Hahn où il fait la description du territoire de l'Albanie, ce passage remplissant dix pages d'une écriture serrée et compacte sans compter les notes qui s'y référant à la fin du chapitre. L'auteur détermine d'abord la frontière naturelle de l'Albanie — tant géographique qu'ethnographique — qui s'étend du nord au sud, du Monténégro au golfe d'Arta, c'est à dire du nord d'Antivari à la pointe de Preveza le long de l'Adriatique; il passe ensuite à la description des territoires habités par des Albanais, territoires qu'il divise en quatre groupes. Et en finissant (page 13) il ne manque pas de nous répéter que les Albanais remplissent toute la région qui est comprise entre Moratcha (rivière du Monténégro qui se déverse au nord du lac de Scutari) et Toblitza, c'est à dire de l'extremité septentrionale du lac de Scutari à Nich.

Dans son autre ouvrage intitulé *Reise von Belgrad nach Salonik* (Vienne (1868) Hahn nous apprend que c'est le cours d'eau de la Morava qui sépare la région albanaise de celle des Slaves.

L'ouvrage tout entier a une grande valeur et peut servir de guide à ceux qui veulent étudier la question albanaise, tant au point de vue ethnographique et géographique qu'à celui de l'histoire.

Dans les pages de ce livre — que nous ne pouvons pas rapporter intégralement à cause de leur longuer, et dont nous ne voulons point diminuer la force par un résumé — G. von Hahn donne la majorité incontestable aux Albanais, tant dans la plaine de Kossovo que jusq'au bord du Vardar, à Uskub.

Puis, passant à l'histoire, l'auteur prouve que ces Albanais sont les habitants autochtones de ces parages, étant donné qu'ila sont les descendants des Illyriens, Epirotes, Macédoniens, Dardans, Antariates, Taulantes, Tribals et Desarets. (Lire son chapitre *Zur Geschichte des Morawagebieter*, pages 228-262 de son ouvrage).

Page 38. — Lui aussi (Gabriel Louis-Jaray) il reconnait que l'élément albanais occupe une grande partie du Vilayet de Monastir et tout celui de Kossovo jusque et au delà de la ville d'Uskub. Nous avons d'ailleurs eu l'occasion de citer plus d'une fois des passages du

dernier livre de Gabriel Louis-Jaray, et détachons en encore celui-ci (*Au jeune royaume d'Albanie*, page 170-171):

« La montagne Bukova est située en pays albanais; entre Kertchovo et Gostivar un seul village est bulgare, tous les autres sont albanais; autour de la montagne j'apercois quelques fermes isolées je croise quelques hommes: tous sont des Albanais; nous descendons vers la vallée de Gostivar, le sentier est abrupt et pénible, mais pittoresque; une petite rivière qui va rejoindre le Vardar à Gostivar bondit de roche en roche, forme des cascades, entretient une agréable fraîcheur; sous les arbres qui couvrent ce versant au bas de la descente quelques maisons sont construites le long du torrent; ce sont des Albanais qui nous y offrent l'hospitalité. Le chemin devient route, suit la rivière; ...sur la route se sont des Albanais que nous croisons.

Au débouché des vallées montagneuses du Vardar et de son affluent le Padalichta, Gostivar dissimule derrière des rideaux d'arbres, dans la plaine d'alluvion, ses mille maisons. Il est devenu depuis quelques années un centre important presque entièrement albanais; les neuf dixièmes des habitants sont arnaoutes, le reste bulgare, avec quelques serbes et quelques turcs ».

« La variété des types montre la diversité des nationalités qui habitent la région; mais ici aussi les Albanais ont peu à peu conquis le terrain, acquis les villages et conquis la majorité de la ville: à Kalkandelen (Tetova) sur 5.000 maisons, on en comptait à la veille des guerres 3.000 albanaises, 1.200 serbes et 800 bulgares; un club y avait été organisé sous le nom de Club International, mais il est devenu de fait albanais; d'après les renseignements recueillis ici, sur 100 villages du Kaïmakamlik ou sous préfecture de Kalkandelen, 68 sont albanais, le reste bulgare et serbe, surtout bulgare; dans la région de Gostivar sur 60 villages, 40 sont albanais, le reste bulgare et quelques uns serbes ». (Au jeune Royaume d'Albanie, page 80).

« Je veux voir les Albanais de la plaine d'Uskub à Mitrovitza, et de Mitrovitza à Prizren, de la sorte j'ai l'avantage de me rendre compte des conquêtes albanaises sur les serbes de la« Vieille Serbie » et de la vie des Albanais des villes; à Uskub, Prishtina et Mitrovitza ils sont déjà nombreux; ils sont les maitres incontestés à Ja-

kova, Prizrend et Ipek ». (Gabriel Louis-Jaray, *L'Albanie inconnue*, p. XXI).

« D'après de bons observateurs locaux Uskub compterait environ 45.000 âmes; sur ce nombre on peut évaluer les musulmans, presque tous Albanais, à 25.000, les Bulgares à 10.000 ou 15.000, les Serbes à 3.000, les Juifs à 2.000 ». (Id., ibid., p. 9). Plus haut page XIV (introduction) il avait dit: « Uskub est à la fois une de leurs citadelles avancées et une de leurs métropoles (des Albanais) ».

« Si l'on visite les villages de la plaine d'Uskub et qu'on interroge les habitants, on trouvera les vérités les plus curieuses, propres à détruire les idées toutes faites: voici un village chrétien; il parle un dialecte albanais; son pope est orthodoxe et dépend de l'exarque; si on demande aux gens de ce village ce qu'ils sont, ils répondent: nous sommes bulgares. Voici un autre village: les paysans sont musulmans; leur langue est le slave-bulgare; le type physique est albanais et ils se disent albanais ». (Id., ibid., page 10).

« Ipek est ajourd'hui la ville albanaise par excellence... (Id., ibid., p. 52). Ipek est la grande ville albanaise du nord... Constituant un centre populeux et une agglomération riche, elle est le séjour des plus riches beys du nord; c'est ici que résident ou résidaient une trentaines de familles nobles, chefs héréditaires des grandes tribus de l'intérieur ». (Id., Ibid. p. 56).

« Les relations à Diakova entre Albanais catholiques et Albanais musulmans sont excellentes... Quant aux rapports avec les Serbes il est inutile d'en parler: à Diakova sur les 3.000 maisons de la ville, on compte à peine une douzaine de maisons de pauvres serbes et pas une aux environs. Le pays est done purement albanais ». (Id., ibid., p. 71).

De Diakova à Prizrend, il faut six heures. C'est jour de grand marché et pendant les deux dernières heures de mon voyage je croise sur la route au moins trois ou quatre cents paysans, presque tous Albanais ». (Id., ibid., p. 72).

Page 41. — Nous ne pouvons pas résister à la tentation de reproduire ici quelques données statistiques qui sont dues à un représentant officiel de la Grèce, à Epaminondas Mavromatis, consul hellénique de 1876-1881 à Scutari. Il a publié son étude dans le journal

